| DRAFTLIGJI NGA QEVERIA QË I PROPOZUAR KOMISIONIT TË KUVENDIT | DRAFTLIGJI I REKOMANDUAR NGA EXPERTI XHEVA MEHA | **LIGJI Nr. 04/L-014 I MIRATUAR NGA KUVENDI I KOSOVËS** |
|---|---|---|
| **REPUBLIKA E KOSOVËS<br>KUVENDI** | **REPUBLIKA E KOSOVËS<br>KUVENDI** | **Kuvendi i Republikës së Kosovës;** |
| Në mbështetje të nenit 65 paragrafi (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, | Në mbështetje të nenit 65 paragrafi (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, | Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, |
| Miraton | Miraton | Miraton |
| **LIGJIN PËR KONTABILITET, RAPORTIM FINANCIAR DHE AUDITIM** | **LIGJIN PËR KONTABILITET, RAPORTIM FINANCIAR DHE REVIZION** | **LIGJ PËR KONTABILITET, RAPORTIM FINANCIAR DHE AUDITIM** |
| **KREU I** | **KREU I** | **KREU I** |
| **DISPOZITAT E PËRGJITHSHME** | **DISPOZITAT E PËRGJITHSHME** | **DISPOZITAT E PËRGJITHSHME** |
| **Neni 1<br>Qëllimi** | **Neni 1<br>Qëllimi** | **Neni 1<br>Qëllimi** |
| Me këtë Ligj rregullohet sistemi i kontabilitetit dhe raportimit financiar i shoqërive tregtare, kompetencat dhe përgjegjësitë e Këshillit Kosovar për Raportim Financiar, raportimin financiar nga ana e shoqërive tregtare, kërkesave për auditim, kualifikimet për kontabilistë profesional, licencimin e auditorëve dhe firmave vendore e të huaja të auditimit. | Me këtë Ligj rregullohet kontabiliteti dyjësor dhe raportimi financiar i ndërmarrjeve dhe subjekteve tjera, kompetencat dhe përgjegjësitë e Këshillit Kosovar për Raportim Financiar, kërkesave për revizion, kontabilistë profesional, licencimin revizovëve dhe firmave vendore e të huaja të revizionit. | Me këtë ligj rregullohet sistemi i kontabilitetit dhe raportimit financiar i shoqërive tregtare, kompetencat dhe përgjegjësitë e Këshillit të Kosovës për Raportim Financiar, kërkesat për auditim, kualifikimet për kontabilistë profesional, licencimi i auditorëve dhe firmave vendore e të huaja të auditimit. |
| **Neni 2<br>Përkufizimet** | **Neni 2<br>Përkufizimet** | **Neni 2<br>Përkufizimet** |
| 1. Për qëllime të këtij Ligji, termat e mëposhtëm kanë kuptimin si në vijim: | 1. Për qëllime të këtij Ligji, termat e mëposhtëm kanë kuptimin si në vijim: | 1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim: |

| | | |
|---|---|---|
| 1.1. **Mbajtja e kontabilitetit-** është regjistrimi sistematik në ditar dhe në llogari i të gjitha veprimeve dhe fakteve ekonomike, që i përkasin një njësie ekonomike.<br><br>1.2. **Sistem kontabël-** nënkupton "një strukturë e organizuar e përbërë nga manuale dhe metoda për kontabilitete të kompjuterizuara, procedura dhe kontroll të disenjuar që të mbledhin, regjistrojnë, klasifikojnë, analizojnë, përmbledhin, interpretojnë dhe prezantojnë të dhëna të sakta dhe kohore për vendimet e menaxhmentit".<br><br>1.3. **Raporti vjetor-** nënkupton një raport nga organizatat e biznesit për periudhën vjetore që përfshinë pasqyrat financiare për qëllime të përgjithshme të audituara së bashku me opinionin e auditorit, duke përfshirë përveç pasqyrave financiare dhe raportit të auditorit, edhe:<br><br>1.3.1. një rishikim të drejtë të zhvillimit dhe performacës së biznesit dhe pozitës së tij, së bashku me përshkrimin e rreziqeve dhe pasigurisë që ata kanë hasur.<br>1.3.2. deri në nivelin e nevojshëm për të kuptuar zhvillimin e kompanisë, performancën ose pozitën, analiza duhet të përfshij analizën financiare dhe nëse është e përshtatshme, indikatorët jo financiar kyq që janë relevant për atë biznes.<br>1.3.3. të dhënat për:<br><br>1.3.3.1. çdo ngjarje të rëndësishme që ka ndodh që nga fundi i vitit financiar;<br>1.3.3.2. zhvillimet e parashikueshme në të ardhmen e kompanisë;<br>1.3.3.3. aktivitete në fushën e hulumtimit dhe zhvillimit; | 1.1. **Mbajtja e kontabilitetit-** është regjistrimi kronologjik në ditar, regjistrimi sistematik në librat e kontabilitetit i të gjitha veprimeve dhe fakteve ekonomiko-financiare që i përkasin një njësie ekonomike.<br><br>1.2. **Sistem kontabël-** nënkupton "strukturë e organizuar që përmban mbajtjen me dorë ose në mënyrë të kompjuterizuar të kontabilitetit, procedura dhe kontroll të disenjuar që të mbledhin, regjistrojnë, klasifikojnë, analizojnë, përmbledhin, interpretojnë dhe prezantojnë të dhëna të sakta dhe ne kohen e duhur për vendimmarrjet e menaxhmentit".<br><br>1.3. **Raporti vjetor-** nënkupton pasqyren financiare nga ndërmarrjet dhe subjektet tjera për periudhën vjetore që përfshinë pasqyrat financiare për qëllime të përgjithshme së bashku me mendimin e revizorit kurë është e aplikushme. | 1.1. **Mbajtja e kontabilitetit -** regjistrimi kronologjik në ditar, regjistrimi sistematik në librat e kontabilitetit i të gjitha veprimeve dhe fakteve ekonomiko-financiare, që i përkasin një njësie ekonomike.<br><br>1.2. **Sistem kontabël –** strukturë e organizuar që përmban mbajtjen me dorë ose në mënyrë të kompjuterizuar të kontabilitetit, procedura dhe kontroll të disenjuar që të mbledhin, regjistrojnë, klasifikojnë, analizojnë, përmbledhin, interpretojnë dhe prezantojnë të dhëna të sakta dhe në kohën e duhur për vendimmarrjet e menaxhmentit.<br><br>1.3. **Raporti vjetor -** një raport nga shoqëritë tregtare dhe subjektet tjera për periudhën vjetore që përfshinë pasqyrat financiare për qëllime të përgjithshme së bashku me mendimin e auditorit kur është e aplikueshme. |

| | | |
|---|---|---|
| 1.3.3.4. informatat që kanë të bëjnë me përvetësimin e ndarjes së saj;<br>1.3.3.5. ekzistimi i degëve të kompanisë.<br><br>1.4. **Firmë auditimi-** nënkupton një person juridik ose çfarëdo entiteti tjetër, pa marrë parasysh formën ligjore, që është i aprovuar në përputhshmëri me këtë Ligj për të kryer punët e auditimit ligjor.<br><br>1.5. **BQK-** nënkupton Banka Qendrore e Republikës së Kosovës.<br><br>1.6. **Pasqyra financiare për qëllim të përgjithshëm PFQP-** nënkupton bilancin e gjendjes, pasqyrën e të ardhurave, pasqyrën e rrjedhës së parasë, pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet dhe shënimet plotësuese dhe materialet sqaruese që janë pjesë integrale e pasqyrave financiare të një shoqërie tregtare.<br><br>1.7. **Shoqëri Tregtare e Kosovës-** është term i përgjithshëm që do të thotë dhe përfshin çfarëdo lloji të shoqërisë tregtare të themeluar në Kosovë sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare.<br><br>1.8. **Shoqëria e Huaj Tregtare-** nënkupton Shoqërinë e Huaj Tregtare e përcaktuar me Ligjin për Shoqëritë Tregtare.<br><br>1.9. **MF-** nënkupton Ministrinë e Financave.<br><br>1.10. **Ministër-** nënkupton ministrin e MF. | 1.4. **Firmë revizioni -** nënkupton personin juridik ose çfarëdo entiteti tjetër, pa marrë parasysh formën ligjore, që është i miratuar në përputhshmëri me këtë Ligj për të kryer punët e revizionit.<br><br>1.5. **BQK-** nënkupton Banka Qendrore e Republikës së Kosovës.<br><br>1.6. **Pasqyra financiare për qëllim të përgjithshëm PFQP-** nënkupton bilancin e gjendjes (pasqyra e pozitës financiare), pasqyrën e të ardhurave, pasqyrën e rrjedhës së parasë, pasqyrën e ndryshimeve në kapital/ekuitet/fonde dhe shënimet shtesë/plotësuese që janë pjesë përbërese e pasqyrave financiare të një ndërmarrjeje.<br><br>1.7. **Ndërmarrje e Kosovës-** është kuptim i përgjithshëm që u referohet llojeve të ndërmarrjeve të themeluara në Kosovë sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare.<br><br>1.8. **Korporatë** – nënkupton nërmarrjen e themeluar si korporatë në bazë të ligjit mbi shoqëritë tregtare.<br><br>1.9. **Nërmarrje e Huaj** - nënkupton ndërmarrjen e Huaj e përcaktuar me Ligjin për Shoqëritë Tregtare.<br><br>1.10. **MF-** nënkupton Ministrinë e Financave.<br><br>1.11. **Ministër-** nënkupton ministrin e MF.<br><br>1.12 **SIC-** Standing Interpretation Committee (Komiteti i Përhershëm për Interpretime<br><br>1.13 **IFRIC -** International Financial Reporting Interpretations Committee (Komiteti Ndërkombtar i Interpretimeve për Raportime Financiar. | 1.4. **Firmë auditimi -** person juridik ose çfarëdo entiteti tjetër, pa marrë parasysh formën ligjore, që është e licencuar, në përputhshmëri me këtë ligj për të kryer punët e auditimit.<br><br>1.5. **BQK -** Banka Qendrore e Republikës së Kosovës.<br><br>1.6. **Pasqyra financiare për qëllim të përgjithshëm (PFQP) -** bilanci i gjendjes, pasqyrën e të ardhurave, pasqyrën e rrjedhës së parasë, pasqyrën e ndryshimeve në ekuitete, shënimet plotësuese dhe materialet sqaruese, që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.<br><br>1.7. **Shoqëri Tregtare -** çfarëdo lloji i shoqërisë tregtare të themeluar në Kosovë sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare.<br><br>1.8. **Shoqëria e Huaj Tregtare -** Shoqërinë e huaj tregtare e përcaktuar me Ligjin për Shoqëritë Tregtare.<br><br>1.9. **MF -** Ministria e Financave.<br><br>1.10. **Ministër -** Ministri e MF.<br><br>1.11. **SIC -** Komiteti i përhershëm për interpretime.<br><br>1.12. **IFRIC -** Komiteti Ndërkombëtar i Interpretimeve për Raportim Financiar. |

| | | |
|---|---|---|
| | | 1.13. **IAASB** –Bordi Ndërkombëtar për Standardet e Auditimit dhe Sigurisë.<br><br>1.14. **IFAC** –Federata Ndërkombëtare e Kontabilisteve. |
| 1.11.**SNK-** nënkupton Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK), Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), dhe interpretimet në lidhje me (interpretimet e SIC-IFRIC), amandamentet e mëpastajme për këto standarde dhe interpretimet lidhur me to, si dhe standardet për të ardhmen sikur edhe interpretimet me to, të lëshuara dhe të adoptuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombtare të Kontabilitetit (BSNK). | 1.14. **SNK-** nënkupton Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK), Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), dhe interpretimet në lidhje me standarde (interpretimet e SIC-IFRIC), amandamentet e mëpastajme për këto standarde dhe interpretimet lidhur me to, si dhe standardet për të ardhmen sikur edhe interpretimet për to, të lëshuara dhe të adoptuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombtare të Kontabilitetit (BSNK). | 1.15. **SNK -** Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK), Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) dhe interpretimet në lidhje me (interpretimet e SIC-IFRIC), amendamentet e mëpastajme për këto standarde dhe interpretimet lidhur me to, si dhe standardet për të ardhmen sikur edhe interpretimet me to, të lëshuara dhe të adoptuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK). |
| 1.12. **SNA-** nënkupton Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të lëshuara nga BNSA. | 1.15. **SNR-** nënkupton Standardet Ndërkombëtare të Revizionit të lëshuara nga BSNSR. | 1.16. **SNA -** Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të lëshuara nga BSNA. |
| 1.13. **FNK-** nënkupton Federatën Ndërkombëtare të Kontabilistëve. | 1.16. **FNK-** nënkupton Federatën Ndërkombëtare të Kontabilistëve. | 1.17. **FNK -** Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve. |
| 1.14. **BSNAS-** nënkupton Bordin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit dhe Sigurisë të FNK-së. | 1.17. **BSNRS-** nënkupton Bordin e Standardeve Ndërkombëtare të Revizionit dhe Sigurisë të FNK-së. | 1.18. **BSNAS -** Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit dhe Sigurisë të FNK-së. |
| 1.15. **BSNK-** nënkupton Bordin e Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit. | 1.18. **BSNK-** nënkupton Bordin e Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit. | 1.19. **BSNK -** Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit. |
| 1.16. **SKK-** nënkupton Standardet Kosovare të Kontabilitetit. | 1.19. **SKK-** nënkupton Standardet Kosovare të Kontabilitetit. | 1.20. **SKK -** Standardet Kosovare të Kontabilitetit. |
| 1.17. **KKRF-** nënkupton Këshillin Kosovar për Raportime Financiare. | 1.20. **KKRF-** nënkupton Këshillin Kosovar për Raportime Financiare. | 1.21. **KKRF -** Këshilli i Kosovës për Raportim Financiar. |
| 1.18. **SHKÇAK-** nënkupton Shoqatën e Kontabilistëve të Certifikuar dhe Auditorëve të Kosovës. | 1.21. **SHKÇAK-** nënkupton Shoqatën e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të Kosovës. | |
| 1.19. **BKSRF –** Bordi Kosovar mbi Standardet për | 1.22. **BKSRF-** nënkupton Bordin Kosovar mbi Standardet | 1.22. **BKSRF –** Bordi Kosovar mbi Standardet |

| | | |
|---|---|---|
| Raportim Financiar.<br><br>1.20. **Auditor ligjor-** nënkupton personin fizik i cili është licencuar në përputhshmëri me këtë Ligj, për të kryer auditimin ligjor.<br><br>1.21. **Partnerët kyç të Auditimit-** nënkupton:<br>1.21.1. auditorin ligjor të emëruar nga një firmë e auditimit për një angazhim të caktuar të auditimit, që është përgjegjës kryesisht për kryerjen e auditimit ligjor në emër të firmës së auditimit;<br><br>1.21.2. në rast të grupit, së paku auditorët ligjor emërohen nga një firmë e auditimit që të jenë përgjegjës kryesisht për të kryer auditimin ligjor në nivel të grupit dhe auditimit ligjor të emëruar që të jetë përgjegjës kryesisht në nivel të materialeve suplementare, apo<br>1.21.3. auditorëve ligjor të cilët e nënshkruajnë raportin e auditimit.<br><br>1.22. **Person-** nënkupton personin fizik ose personin juridik.<br><br>1.23. **Shoqatë profesionale e kontabilitetit dhe auditivit -** nënkupton një organizatë jofitimprurëse e cila është themeluar për të promovuar dhe përparuar pozitën, efikasitetin dhe dobishmërinë e profesionit të kontabilitetit publik që ka të bëj ose me ofrimin e shërbimeve nga kontabilistët në sektor publik ose të ofrimit të shërbimeve në industri, tregti, edukim apo çfarëdo shërbimi tjetër.<br><br>**KREU II**<br><br>**Neni 3**<br>**Raportimi Financiar**<br><br>1. Shoqëritë tregtare përgatitin pasqyrat financiare për | për Raportim Financiar.<br><br>1.23. **Revizor -** nënkupton personin fizik i cili është licencuar në përputhshmëri me këtë Ligj, për të kryer revizionin.<br><br>1.24. **Partnerët e Revizionit-** nënkupton:<br>1.24.1. revizorin e licensuar të emëruar nga një firmë e revizionit për një angazhim të caktuar revizioni, i cili është përgjegjës kryesor për kryerjen e revizionit në emër të firmës së revizionit;<br><br>1.24.2. në rast të grupit, revizorët e licensuar që emërohen nga firma e revizioit që të jenë përgjegjës kryesor për kryerjen e revizionit në nivel të grupit,<br><br>1.24.3. Revizorin e licensuar i cili e nënshkruan raportin e revizorit.<br><br>1.25. **Person-** nënkupton personin fizik ose personin juridik.<br><br>1.26. **Shoqatë profesionale e kontabilitetit dhe revizionit -** nënkupton organizaten jofitimprurëse e cila është themeluar për të promovuar dhe avancuar pozitën, efikasitetin dhe dobishmërinë e profesionit të kontabilitetit si interes i përgjithshëm.<br><br>**KREU II**<br><br>**Neni 3**<br>**Raportimi Financiar**<br><br>1. Ndërmarrjet përgatitin pasqyrat financiare për qëllime të | për Raportim Financiar.<br><br>1.23. **Auditor -** personi fizik i cili është licencuar në përputhshmëri me këtë ligj.<br><br>1.24**. Partnerët kyç të auditimit** – nënkupton:<br>1.24.1. auditorin e licencuar të emëruar nga një firmë e auditimit për një angazhim, i cili është përgjegjës kryesor për kryerjen e auditimit në emër të firmës së auditimit;<br><br>1.24.2. në rast të grupit të auditorëve, firmat e auditimit emërojnë auditorët përgjegjës për të kryer auditimin në nivel të grupit.<br>1.24.3. auditorëve të cilët e nënshkruajnë raportin e auditimit.<br><br>1.25. **Person -** personi fizik ose personi juridik.<br><br>1.26. **Shoqatë profesionale e kontabilitetit dhe auditimit** –organizata jofitimprurëse e cila është themeluar për të promovuar dhe avancuar pozitën, efikasitetin dhe dobishmërinë e profesionit të kontabilitetit si interes i përgjithshëm.<br><br>**KREU II**<br><br>**Neni 3**<br>**Raportimi Financiar**<br><br>1. Shoqëritë tregtare përgatisin pasqyrat |

| | | |
|---|---|---|
| qëllime të përgjithshme në pajtim me këtë Ligj.<br><br>2. Shoqëritë tregtare që kryejnë aktivitetin e tyre me mjete shoqërore apo publike do të përgatitin pasqyra financiare për qëllime të përgjithshme në pajtim me këtë Ligj.<br><br>3. Shoqëritë tregtare me rastin e përgatitjeve të pasqyrave financiare për qëllime të përgjithshme, aplikojnë standardet e kontabilitetit, rregulloret dhe udhëzimet administrative të lëshuara nga KKRF-ja sipas nenit të 5 të këtij Ligji.<br><br>4. Pavarësisht nga paragrafi i 3 i këtij neni, shoqëritë tregtare mund të përgatisin pasqyra financiare plotësisht në pajtim me SNRF-në duke njoftuar KKRF-në.<br><br>**Neni 4**<br>**Klasifikimi i Shoqërive Tregtare**<br><br>1. Kategoritë e shoqërive tregtare për qëllim të raportimit financiar klasifikohen si vijon:<br><br>1.1. Shoqëritë tregtare të mëdha janë ato të cilat plotësojnë dy nga tri kriteret në vijim:<br><br>1.1.1. Qarkullim vjetor (neto): më i madh se 4 milion euro (4.000.000,00);<br>1.1.2. Asetet (pasuritë) bruto në bilancin e gjendjes: më të mëdha se 2 milion euro (2.000.000,00);<br>1.1.3. Numri mesatar i të punësuarve gjatë vitit financiar: më i madh se 50.<br><br>1.2. Shoqëritë tregtare të mesme janë ato të cilat plotësojnë dy nga tri kriteret në vijim: | përgjithshme në pajtim me këtë Ligj.<br><br>2. Ndërmarrjet që kryejnë aktivitetin e tyre me mjete shoqërore ose publike përgatisin pasqyra financiare për qëllime të përgjithshme në pajtim me këtë Ligj.<br><br>3. Korporatat gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare për qëllime të përgjithshme, aplikojnë standardet e kontabilitetit, rregulloret dhe udhëzimet administrative të lëshuara nga KKRF-ja sipas nenit të 5 të këtij Ligji.<br><br>4. Pavarësisht nga paragrafi i 3 i këtij neni, korporatat mund të përgatisin pasqyra financiare plotësisht në pajtim me SNRF-në duke njoftuar KKRF-në.<br><br>**Neni 4**<br>**Klasifikimi i Ndërmarrjeve**<br><br>1. Ndërmarrjet për qëllim të raportimit financiar klasifikohen si vijon:<br><br>1.1. Ndërmarrje të mëdha janë ato të cilat plotësojnë dy nga tri kriteret në vijim:<br><br>1.1.1. Të hyrat vjetore (neto): më shumë se 4 milionë euro (4.000.000,00);<br>1.1.2. Asetet (pasuritë) bruto në bilancin e gjendjes: më të mëdha se 2 milion euro (2.000.000,00);<br>1.1.3. Numri mesatar i të punësuarve gjatë vitit financiar: më i madh se 50.<br><br>1.2. Ndërmarrjet e mesme janë ato të cilat plotësojnë dy nga tri kriteret në vijim: | financiare për qëllime të përgjithshme në pajtim me këtë ligj.<br><br>2. Shoqëritë tregtare që kryejnë aktivitetin e tyre me mjete shoqërore apo publike do të përgatisin pasqyra financiare për qëllime të përgjithshme në pajtim me këtë ligj.<br><br>3. Shoqëritë tregtare me rastin e përgatitjeve të pasqyrave financiare për qëllime të përgjithshme, aplikojnë standardet e kontabilitetit, rregulloret dhe udhëzimet administrative të lëshuara nga KKRF-ja sipas nenit të 5 të këtij ligji.<br><br>4. Pavarësisht nga paragrafi 3. i këtij neni, shoqëritë tregtare mund të përgatisin pasqyra financiare plotësisht në pajtim me SNRF-në duke njoftuar KKRF-në.<br><br>**Neni 4**<br>**Klasifikimi i Shoqërive Tregtare**<br><br>1. Kategoritë e shoqërive tregtare për qëllim të raportimit financiar klasifikohen si vijon:<br><br>1.1. shoqëritë tregtare të mëdha janë ato të cilat plotësojnë dy nga tri kriteret në vijim:<br><br>1.1.1. qarkullim vjetor (neto): më i madh se katër milion (4000000) Euro;<br>1.1.2. asetet (pasuritë) bruto në bilancin e gjendjes: më të mëdha se dy milion euro (2000000) Euro;<br>1.1.3. numri mesatar i të punësuarve gjatë vitit financiar: më i madh se 50.<br><br>1.2. shoqëritë tregtare të mesme janë ato të cilat plotësojnë dy nga tri kriteret në vijim: |

| | | |
|---|---|---|
| 1.2.1. Qarkullim vjetor (neto): më i madh se 2 milon (2.000.000,00)€ mirëpo më i vogël se 4 milion euro (4.000.000,00):<br>1.2.2. Asetet (pasuritë) bruto në bilancin e gjendjes: në mbi 1 milion (1.000.000,00)€ dhe me pak se 2 milion (2.000.000.00) euro;<br>1.2.3. Numri mesatar i të punësuarve gjatë vitit financiar: më i madh se 10 mirëpo më i vogël se 50.<br>1.3. Shoqëritë tregtare të vogla janë ato të cilat i plotësojnë dy nga tri kriteret në vijim:<br><br>1.3.1. Qarkullim vjetor (neto): më i madh se 50.000,00 € mirëpo më i vogël se 2 milion € (2.000.000,00):<br>1.3.2. Asetet (pasuritë) bruto në bilancin e gjendjes: në mbi 25.000,00 € dhe më pak se 1 milon (1.000.000.00) €;<br>1.3.3. Numri mesatar i të punësuarve gjatë vitit financiar: deri në 10.<br><br>1.4. Mikro-ndërmarrjet: janë ato biznese që kanë qarkullim vjetor, vlerë të aseteve (pasurive) dhe numrin mesatar të të punësuarve më të ulët se pragu që është paraqitur në paragrafin 4.1. të këtij neni, që do të thotë:<br><br>1.4.1. Qarkullim vjetor (neto): më pak se 50.000,00 €;<br>1.4.2. Asetet (pasuritë) bruto në datën e bilancit të gjendjes: më pak se 25.000,00 €;<br>1.4.3. Numri mesatar i të punësuarve gjatë vitit financiar: më i vogël se 10.<br><br>2. Kriteret për kontabilitet dhe raportim të aplikueshme për mikro ndërmarrjet do të rregullohen nga KKRF-ja me qëllim të minizimit të punës administrative për mikro- ndërmarrjet. | 1.2.1. Të hyrat vjetore (neto): më shumë se 2 milonë (2.000.000,00)€ mirëpo më pak se 4 milionë euro (4.000.000,00):<br>1.2.2. Asetet (pasuritë) bruto në bilancin e gjendjes: në mbi 1 milionë (1.000.000,00)€ dhe me pak se 2 milionë (2.000.000.00) euro;<br>1.2.3. Numri mesatar i të punësuarve gjatë vitit financiar: më i madh se 10 mirëpo më i vogël se 50.<br><br>1.3. Ndërmarrje të vogla janë ato të cilat i plotësojnë dy nga tri kriteret në vijim:<br><br>1.3.1. Të hyrat vjetore (neto): më shumë se 50.000,00 € mirëpo më pak se 2 milionë € (2.000.000,00):<br>1.3.2. Asetet (pasuritë) bruto në bilancin e gjendjes: në mbi 25.000,00 € dhe më pak se 1 milon (1.000.000.00) €;<br>1.3.3. Numri mesatar i të punësuarve gjatë vitit financiar: deri në 10.<br><br>1.4. Mikro-ndërmarrje janë ato biznese që kanë qarkullim vjetor, vlerë të aseteve (pasurive) dhe numrin mesatar të të punësuarve më të ulët se pragu që është paraqitur në paragrafin 4.1. të këtij neni, që do të thotë:<br><br>1.4.1. Të hyrat vjetore (neto): më pak se 50.000 €;<br>1.4.2. Asetet (pasuritë) bruto në datën e bilancit të gjendjes: më pak se 25.000,00 €;<br>1.4.3. Numri mesatar i të punësuarve gjatë vitit financiar: më i vogël se 10.<br><br>2. Kriteret për kontabilitet dhe raportim të aplikueshme për mikro-ndërmarrje do të rregullohen nga KKRF me nënligje të veqanta me qëllim të minizimit të punës administrative për mikro- ndërmarrjet. | 1.2.1. qarkullim vjetor (neto): më i madh se dy milion (2000000) mirëpo më i vogël se katër milion (4000000) Euro:<br>1.2.2. asetet (pasuritë) bruto në bilancin e gjendjes: në mbi një milion (1000000) dhe me pak se dy milion (2000000) Euro;<br>1.2.3. numri mesatar i të punësuarve gjatë vitit financiar: më i madh se 10 mirëpo më I vogël se 50.<br>1.3. shoqëritë tregtare të vogla janë ato të cilat i plotësojnë dy nga tri kriteret në vijim:<br><br>1.3.1. qarkullim vjetor (neto): më i madh se pesëdhjetëmijë (50000) mirëpo më i vogël se dy milion (2000000) Euro:<br>1.3.2. asetet (pasuritë) bruto në bilancin e gjendjes: në mbi njëzetepesëmijë (25000) dhe më pak se një milion (1000000) Euro;<br>1.3.3. numri mesatar i të punësuarve gjatë vitit financiar: deri në 10.<br><br>1.4. mikro-ndërmarrjet: janë ato biznese që kanë qarkullim vjetor, vlerë të aseteve (pasurive) dhe numrin mesatar të të punësuarve më të ulët se pragu që është paraqitur në këtë nënparagraf, që do të thotë:<br><br>1.4.1. qarkullim vjetor (neto): më pak se pesëdhjetëmijë (50000) Euro;<br>1.4.2. asetet (pasuritë) bruto në datën e bilancit të gjendjes: më pak se njëzetepesëmijë (25000) Euro;<br>1.4.3. numri mesatar i të punësuarve gjatë vitit financiar: më i vogël se 10.<br><br>2. Kriteret për kontabilitet dhe raportim të aplikueshme për mikro ndërmarrjet do të rregullohen nga KKRF-ja me qëllim të minizimit të punës administrative për mikro-ndërmarrjet. |

| | | |
|---|---|---|
| **Neni 5**<br>**Zbatimi i SNRF, SNK, SKK dhe SNA dhe kërkesave tjera për përgatitjen dhe auditivin e pasqyrave financiare** | **Neni 5**<br>**Zbatimi i SNRF, SNK, SKK dhe SNR dhe kërkesave tjera për përgatitjen dhe revizionimin e pasqyrave financiare** | **Neni 5**<br>**Zbatimi i SNRF, SNK, SKK dhe SNA dhe kërkesave tjera për përgatitjen dhe auditimin e pasqyrave financiare** |
| 1. Shoqëritë tregtare të mëdha në Kosovë sipas nenit 4 të këtij ligji duhet të aplikojnë SNK/SNRF dhe interpretimet, rekomandimet dhe këshillimet e nevojshme të lëshuara nga Bordi për Standarde Ndërkombëtare të Kontabilitetit të cilat miratohen nga KKRF-ja. | 1. Korporatat e mëdha në Kosovë sipas nenit 4 paragrafi 1.1 të këtij ligji duhet të aplikojnë SNK/SNRF dhe interpretimet, rekomandimet dhe këshillimet e nevojshme të lëshuara nga Bordi për Standarde Ndërkombëtare të Kontabilitetit të cilat miratohen nga KKRF-ja. | 1. Shoqëritë tregtare të mëdha në Kosovë sipas nenit 4 të këtij ligji duhet të aplikojnë SNK/SNRF dhe interpretimet, rekomandimet dhe këshillimet e nevojshme të lëshuara nga Bordi për Standarde Ndërkombëtare të Kontabilitetit të cilat miratohen nga KKRF-ja. |
| 2. Të gjitha shoqëritë tregtare sipas nenit 4 nën paragrafit 1.2 dhe 1.3, përgatisin pasqyrat e tyre financiare në pajtim me SKK-në. | 2. Të gjitha korporatat sipas nenit 4 nën paragrafët 1.2 dhe 1.3, përgatisin pasqyrat e tyre financiare në pajtim me SKK-në. | 2. Shoqëritë tregtare sipas nenit 4, paragrafi 1. nën-paragrafët 1.1., 1.2. dhe 1.3., që janë të regjistruara si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar ose shoqëri aksionare, përgatisin pasqyrat financiare në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, të lëshuara nga Bordi për Standarde Ndërkombëtare të Kontabilitetit, të cilat miratohen nga KKRF-ja. |
| 3. Pasqyrat financiare të konsoliduara të shoqërive tregtare sipas paragrafit 1 të këtij neni bëhen sipas Direktivës 78/660/EEC BE-së dhe SNRF-së. | 3. Pasqyrat financiare të konsoliduara të ndërmarrjeve sipas paragrafit 1 të këtij neni bëhen sipas Direktivës 78/660/EEC të BE-së dhe SNRF-së. | 3. Pasqyrat financiare të konsoliduara të shoqërive tregtare sipas paragrafit 1. të këtij neni bëhen sipas Direktivës 78/660/EEC BE-së dhe SNRF-së. |
| 4. Pasqyrat financiare sipas nenit 4.1.1. të këtij Ligji do të auditohen nga firmat ligjore të auditimit që janë të licensuara për të kryer auditime ligjore nga autoritetet kompetente siç janë definuar në këtë Ligj. | 4. Pasqyrat financiare sipas nenit 4.1.1. dhe nenit 4.1.2 të këtij Ligji do të revizionohen nga revizorë të licensuar dhe firma të revizionit të licensuara nga autoritetet kompetente siç janë definuar në këtë Ligj. | 4. Pasqyrat financiare sipas nenit 4 paragrafit 1. nën-paragrafit 1.1. të këtij ligji do të auditohen nga firmat e auditimit që janë të licencuara për të kryer auditim nga autoritetet kompetente siç janë definuar në këtë ligj. |
| 5. Pasqyrat financiare sipas nenit 4.1.2, të këtij ligji do të auditohen nga fimat ligjore auditmit ose auditor ligjor që janë të licensuar për të kryer auditime Ligjore nga autoritetet kompetente sië janë definuar në këtë Ligj. | | 5. Pasqyrat financiare sipas nën-paragrafit nenit 4 paragrafi 1. nën-paragrafët 1.2 të këtij ligji do të auditohen nga firmat e auditmit ose auditor që janë të licencuar për të kryer auditime nga autoritetetkompetente siç janë definuar në këtë ligj. |

| | | |
|---|---|---|
| | 5. Organizatat Jo-Qeveritare (OJQ-të) e regjistruara në bazë të ligjit mbi OJQ-të përgadisin pasqyrat financiare vjetore në përputhje me SKK-të dhe në bazë të përshkrimeve të ligjit mbi OJQ-të, ndërsa revizionohen në bazë të përshkrimeve në këtë ligj. | |
| 6. Të gjitha auditimet Ligjore në Kosovë që përfshijnë të gjitha auditimet e kërkuara nga ky Ligj, dhe auditimet e jashtme të pavarura të bizneseve të tjera për organizatat joprofitabile, organizatat tjera shoqërore apo publike dhe entietet tjera të cilat janë të mandatuara me Ligjet tjera të aplikueshme në Kosovë, do të kryhen në pajtueshmëri me Standardet Ndërkomëbtare të Auditimit (SNA) dhe interpretimet relevante, udhëzimet dhe deklaratat e IAASB, dhe nga auditorët ligjorë që janë të aprovuar për të kryer auditime Ligjore nga autoritetet kompetente siç janë definuar nga ky Ligj. | 6. Të gjitha revizionet e kërkuara nga ky Ligj si dhe revizionimet tjera të jashtme të pavarura të cilat janë të mandatuara me të gjitha Ligjet tjera të aplikueshme në Kosovë, do të kryhen në pajtueshmëri me Standardet Ndërkomëbtare të Revizionit (SNR) dhe interpretimet relevante, udhëzimet dhe deklaratat e IAASB. Të gjitha këto revizionime do të kryhen nga revizorët e licensuar nga autoritetet kompetente siç janë definuar nga ky Ligj. | 6. Të gjitha auditimet në Kosovë që përfshijnë të gjitha auditimet e kërkuara nga ky ligj, dhe auditimet e jashtme të pavarura të bizneseve të tjera për organizatat joprofitabile, organizatat tjera shoqërore apo publike dhe entitetet tjera të cilat janë të mandatuara me ligjet tjera të aplikueshme në Kosovë, do të kryhen në pajtueshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) dhe interpretimet relevante, udhëzimet dhe deklaratat e IAASB, dhe nga auditorët që janë të aprovuar për të kryer auditime nga autoritetet kompetente siç janë definuar nga ky ligj. |
| 7. Autoriteti kompetent për miratimin e Standardeve Ndërkombëtare të auditimit dhe të interpretimeve relevante, udhëzimeve dhe deklaratave të IAASB do të jetë KKRF. | 7. Autoriteti kompetent për miratimin e Standardeve Ndërkombëtare të Revizionit dhe të interpretimeve relevante, udhëzimeve dhe deklaratave të BSNRS do të jetë KKRF. | 7. Autoriteti kompetent për miratimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit dhe të interpretimeve relevante, udhëzimeve dhe deklaratave të IAASB do të jetë KKRF. |
| **Neni 6**<br>**Librat kontabël dhe evidenca mbështetëse** | **Neni 6**<br>**Librat kontabël dhe dëshmitë mbështetëse kontabël** | **Neni 6**<br>**Librat kontabël dhe evidenca mbështetëse** |
| 1. Librat kontabël përbëhen nga :<br>1.1. Ditari;<br>1.2. libri kryesor; dhe<br>1.3. librat ndihmëse. | 1. Librat kontabël përbëhen nga:<br>1.1. Ditari që përmban shënimet kronologjike;<br>1.2. Libri i Madh/Kryesor që përmban shënimet sistematike; dhe<br>1.3. Librat ndihmëse që përmbajnë shënimet sistematike. | 1. Librat kontabël përbëhen nga :<br>1.1. ditari;<br>1.2. libri kryesor; dhe<br>1.3. librat ndihmëse. |
| 2. Evidencat mbështetëse: | 2. Dëshmitë mbështetëse kontabël: | 2. Evidencat mbështetëse: |
| 2.1. Regjistrimet kontabël arsyetohen me evidencë mbështetëse, në formë të dokumenteve ose elektonike, që sigurojnë besueshmërinë e tyre. Evidenca mbështetëse mbahet si provë | 2.1. Regjistrimet kontabël bazohen në dëshmitë e duhura mbështetëse kontabël (dëshmitë kontabël), të cilat janë në formë të dokumenteve të shtypura ose elektronike. Dëshmitë kontabël mbahen si dokumentim i gjurmëve të | 2.1. regjistrimet kontabël arsyetohen me evidencë mbështetëse, të dokumenteve në formë të shtypura ose elektronike, që sigurojnë besueshmërinë e tyre. Evidenca mbështetëse |

| | | |
|---|---|---|
| dokumentuar gjatë gjithë periudhës kohore, të përcaktuar në nenin 12 të këtij ligji.<br><br>2..2. Për çdo regjistrim kontabël duhet të shkruhet origjina, natyra, data dhe përmbajtja e veprimit ekonomik ose e ngjarjes. | transaksioneve dhe aktivieteve gjatë gjithë periudhës kohore, të përcaktuar në nenin 12 të këtij ligji.<br><br>2.2 Secila ndërmarrje duhet të mbajë dëshmitë kontabël të cilat janë të mjaftushme: i) për të treguar dhe sqaruar transaksionet e saj, ii) për të shpalosë me saktësinë e duhur në çdo kohë pozitën financiare dhe iii) për të mundësuar menexhmentin të sigurojë se pasqyrat e përgatitura financiare janë në përputhje me kërkesat e këtij ligji. Dëshmitë kontabël duhet që të përmbajnë: i) regjistrimet e të gjitha shumave ditore të arkëtuara dhe shpenzuara ku shkruhet origjina, natyra, data dhe përmbajtja e veprimit ekonomik ose e ngjarjes, ii) të dhënat mbi asetet dhe detyrimet. Nese aktiviteti ka te bëjë me mallërat – i) poziten e stoqeve të datës së fundvitit financiar, ii) të gjitha raportet e numërimit të stoqeve<br><br>2.3 Në rast se ndonjë aktivitet i ndërmarrjes bëhet me qëllim të mashtrimit ose falsifikimit, secili person që me vetëdije është palë pjesëmarrëse në këtë aktivitet bën shkelje ligjore.<br><br>3. Regjistrimet kontabël bëhen në sistemin e kontabilitetit sipas metodës së mbyllur ku nuk lejohet fshirja e regjistrimit dhe që secili ndryshim mban gjurmët që tregojnë gjendjen para dhe pas ndryshimit. | mbahet si provë dokumentuar gjatë gjithë periudhës kohore, të përcaktuar në nenin 12 të këtij ligji.<br><br>2.2. për çdo regjistrim kontabël duhet të shkruhet origjina, natyra, data dhe përmbajtja e veprimit ekonomik ose e ngjarjes. |
| **Neni 7**<br>**Inventarizimi i pasurisë dhe detyrimeve**<br><br>1. Shoqëritë tregtare, subjekte të këtij Ligji, duhet të verifikojnë të paktën një herë në vit, ekzistencën dhe vlerësimin e aseteve, të detyrimeve dhe të kapitalit, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe evidencës së tyre mbështetëse nëpërmjet procesit të inventarizimit. | **Neni 7**<br>**Inventarizimi i pasurisë dhe detyrimeve**<br><br>1. Ndërmarrjet, subjekte të këtij Ligji, duhet të verifikojnë të paktën një herë në vit për nevoja të fundvitit financiar, ekzistencën dhe vlerën e pasurive (aseteve), të detyrimeve dhe të kapitalit dhe evidencës së tyre mbështetëse përmes procesit të inventarizimit. | **Neni 7**<br>**Inventarizimi i pasurisë dhe detyrimeve**<br><br>1. Shoqëritë tregtare, subjekte të këtij ligji, duhet të verifikojnë të paktën një herë në vit, ekzistencën dhe vlerësimin e aseteve, të detyrimeve dhe të kapitalit, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe evidencës së tyre mbështetëse nëpërmjet procesit të inventarizimit. |

| | | |
|---|---|---|
| 2. Inventarizimi i aseteve dhe detyrimeve kryhet nën përgjegjësinë dhe sipas procedurave të miratuara nga organi drejtues te shoqëritë tregtare. | 2. Inventarizimi i aseteve dhe detyrimeve kryhet nën përgjegjësinë dhe sipas procedurave të miratuara nga organi drejtues i ndërmarrjes. | 2. Inventarizimi i aseteve dhe detyrimeve kryhet nën përgjegjësinë dhe sipas procedurave të miratuara nga organi drejtues te shoqëritë tregtare. |
| **Neni 8**<br>**Gjuha dhe njësia monetare e regjistrave kontabël** | **Neni 8**<br>**Gjuha dhe njësia monetare e regjistrave kontabël** | **Neni 8**<br>**Gjuha dhe njësia monetare e regjistrave kontabël** |
| 1. Regjistrat kontabël mbahen në gjuhën zyrtare të Republikës së Kosovës të përcaktuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe vlerat shprehen në njësinë monetare Euro. | 1. Dëshmitë kontabël mbahen në gjuhën zyrtare të Republikës së Kosovës të përcaktuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe vlerat shprehen në njësinë monetare Euro. | 1. Regjistrat kontabël mbahen në gjuhën zyrtare të Republikës së Kosovës të përcaktuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe vlerat shprehen në njësinë monetare Euro. |
| 2. Dokumentet e shprehura në gjuhë dhe në njësi monetare të huaja, të ardhura ose të dërguara për njësitë ekonomike të huaja, që nuk kanë seli të përhershme në Republikën e Kosovës, vlerësohen në pajtim me përmbajtjen e paragrafit 1 të këtij neni. | 2. Dokumentet e shprehura në gjuhë dhe në njësi monetare të huaja, të ardhura ose të dërguara për njësitë ekonomike të huaja, që nuk kanë seli të përhershme në Republikën e Kosovës, vlerësohen në pajtim me përmbajtjen e paragrafit 1 të këtij neni. | 2. Dokumentet e shprehura në gjuhë dhe në njësi monetare të huaja, të ardhura ose të dërguara për njësitë ekonomike të huaja, që nuk kanë seli të përhershme në Republikën e Kosovës, vlerësohen në pajtim me përmbajtjen e paragrafit 1. të këtij neni. |
| 3. Shoqëritë tregtare sipas nenit 4 nënparagrafi 1.1. dhe 1.2 të këtij ligji mund ti mbajnë regjistrat kontabël edhe në Gjuhën angleze, por janë të detyruara që pasqyrat financiare (bilaci gjendjes, pasqyra e të ardhurave, pasqyra e ndryshimeve në ekuitet, pasqyra e rrjedhës së paras së gatshme dhe shpalosja e shënimeve të pasqyrave financiare) duhet të jenë të përkthyera në gjuhën zyrtare të Republikës së Kosovës. | 3. Ndërmarrjet sipas nenit 4 nënparagrafi 1.1. dhe 1.2 të këtij ligji mund ti mbajnë dëshmitë kontabël edhe në Gjuhën Angleze, por janë të detyruara që pasqyrat financiare (bilanci i gjendjes, pasqyra e të ardhurave, pasqyra e ndryshimeve në ekuitet, pasqyra e rrjedhës së parasë së gatshme dhe shpalosja e shënimeve të pasqyrave financiare) duhet të jenë të përkthyera në gjuhën zyrtare të Republikës së Kosovës. | 3. Shoqëritë tregtare sipas nenit 4, paragrafi 1. nën-paragrafët 1.1. dhe 1.2. të këtij ligji, mund ti mbajnë regjistrat kontabël edhe në Gjuhën angleze, por janë të detyruara që pasqyrat financiare, ti përkthejnë në gjuhë zyrtare të Republikës së Kosovës. |
| **Neni 9**<br>**Raporti financiar vjetor** | **Neni 9**<br>**Raporti financiar vjetor** | **Neni 9**<br>**Raporti financiar vjetor** |
| 1. Pasqyrat financiare vjetore, duhet të përmbajnë këto dokumente: | 1. Pasqyrat financiare vjetore të përgaditura në përputhje me standardet e kontabilitetit sipas paragrafit 5.1 dhe 5.2, duhet të përmbajnë këto dokumente: | 1. Pasqyrat financiare vjetore përmbajnë: |
| 1.1. bilancin e gjendjes;<br>1.2. pasqyrën e të ardhurave dhe të shpenzimeve;<br>1.3. pasqyrën e ndryshimeve në kapital (ekuitet)<br>1.4. pasqyrën e rrjedhës së parasë (cash flow); | 1.1. bilancin e gjendjes (pasqyra e pozitës financiare);<br>1.2. pasqyrën e të ardhurave;<br>1.3. pasqyrën e ndryshimeve në kapital (ekuitet)<br>1.4. pasqyrën e rrjedhës së parasë; | 1.1. bilancin e gjendjes;<br>1.2. pasqyrën e të ardhurave;<br>1.3. pasqyrën e ndryshimit të kapitalit (ekuitetit); |

| | | |
|---|---|---|
| 1.5. shpalosjen e shënimeve të pasqyrave finaciare.<br><br>2. Struktura dhe përmbajta e raporteve financiare vjetore rregullohet me akt nënligjor të nxjerrur nga Ministri i Financave, në bazë të propozimit të KKRF-së. | 1.5. shënimet shtesë/sqaruese të pasqyrave finaciare.<br><br>2. Struktura dhe përrmbajta e raporteve financiare vjetore rregullohet me akt nënligjor të nxjerrur nga KKRF.<br><br>3. Menexhmenti i ndërmarrjes nuk duhet t'i miratojë pasqyrat financiare për qëllime të këtij neni derisa nuk janë të sigurtë se ato paraqesin pamje të drejtë dhe të vërtetë të pasurive (aseteve), detyrimeve dhe poziten financiare. Paqyrat financiare që dorëzohen tek autoritetet duhet të tregojnë emërin e përsonit që nënshkruan në emër të ndërmarrjes. | 1.4. pasqyrën e rrjedhës së parasë;<br>1.5. dokumentet përcjellëse të pasqyrave financiare.<br><br>2. Struktura dhe përmbajta e raporteve financiare vjetore rregullohet me akt nënligjor të nxjerrë nga Ministria e Financave, në bazë të propozimit të KKRF-së.<br><br>3**.** Menaxhmenti i ndërmarrjes nënshkruan pasqyrat financiare dhe mban përgjegjësinë për vërtetësinë e tyre. |
| **Neni 10**<br>**Viti kalendarik kontabël**<br><br>1. Viti kalendarik kontabël fillon me datën 1 janar dhe përfundon në datën 31 dhjetor.<br><br>2. Përjashtimisht nga paragrafi 1 i këtij neni, raporti vjetor financiar përpilohet dhe dorëzohet në rastet:<br><br>2.1. në ditën e hapjes së procedurës të falimentimit dhe<br>2.2. në ditën e ndrrimeve statutore. | **Neni 10**<br>**Viti financiar**<br><br>1. Viti financiar fillon me datën 1 janar dhe përfundon në datën 31 dhjetor.<br><br>2. Përjashtimisht nga paragrafi 1 i këtij neni, raporti vjetor financiar përpilohet dhe dorëzohet në rastet:<br><br>2.1. në ditën e hapjes së procedurës të falimentimit dhe<br><br>2.2. në ditën e ndërrimeve të detyrushme sipas ligjit. | **Neni 10**<br>**Viti kalendarik kontabël**<br><br>1. Viti kalendarik kontabël fillon me datën 1 janar dhe përfundon në datën 31 dhjetor.<br><br>2. Përjashtimisht nga paragrafi 1. i këtij neni, raporti vjetor financiar përpilohet dhe dorëzohet në rastet:<br>2.1. në ditën e hapjes së procedurës të falimentimit dhe<br>2.2. në ditën e ndërrimeve të detyrueshme sipas ligjeve në fuqi. |
| **Neni 11**<br>**Përbërja, dorëzimi dhe publikimi i pasqyrave financiare** | **Neni 11**<br>**Revizionimi, dorëzimi dhe publikimi i pasqyrave financiare**<br><br>1. Personat që i nënështrohen kërkesave të këtij ligji për revizion janë të detyruar që për secilin vit kalendarik të emërojnë revizorin së paku një muaj kalendarik para përfundimit të vitit financiar, përveç nën kushtet kur menexhmenti e asryeton mos-nënështrimin ndaj kërkesave | **Neni 11**<br>**Dorëzimi dhe publikimi i pasqyrave financiare** |

| | | |
|---|---|---|
| | të këtij ligji.<br><br>2. Emërimi i revizorit bëhet vetem pas shpalljes për revizor në njëren nga gazetat ditore. Kërkesat në shpallje duhet të janë plotësisht në përputhje me përshkrimet në këtë ligj dhe çdo kërkesë tjetër është e jashtëligjshme.<br><br>3. Kriteret e përzgjedhjes së revizorit duhet të jenë të kufizuara në kërkesën e standardit të revizionit që është kësisoj: “Praktikuesi duhet të jetë i bindur se ata që e kryejnë angazhimin bashkërisht kanë ekspertizën e nevojshme profesionale për ta kryer angazhimin”. Të gjitha kriteret tjera përveç asaj për “Revizor të Licensuar” janë të jashtëligjshme. Po ashtu marrja dhe dhënia e shpërblimeve dhe beneficioneve tjera nga ato të përshkruara në kontratën e angazhimit janë të jashtëligjshme.<br><br>4. Raporti i revizorit në pasqyrat vjetore duhet të përfshijë: i) hyrjen që identifikon pasqyrat vjetore që revizionohen dhe standardet e raportimit financiar të përdorur në përgaditjen e tyre, dhe ii) përshkrimin e shtrirjes së revizionimit e cila identifikon standardet e revizionit në bazë të të cilave është kryer revizioni.<br><br>5. Raporti i revizorit duhet të paraqesë në mënyrë të qartë se sipas mendimit të revizorit, pasqyrat financiare vjetore: i) japin pamje të drejtë dhe të vërtetë të gjendjes së aktiviteteve afariste dhe fitimit ose humbjes së ndërmarrjes, ii) janë përgaditur në përputhje me kërkesat e raportimit financiar, iii) janë përgaditur në përputhje me kërkesat e këtij ligji.<br><br>6. Raporti i revizorit: i) duhet të jetë ose i pa cilësuar ose i cilësuar, dhe ii) duhet të përfshijë referim tek cilado qështje që revizori dëshiron të tërheq vëmendjen përmes theksimit pa cilësimin e raportit.<br><br>7. Revizori në përgaditjen e raportit duhet të kryejë aq hulumtime sa të mund të formojë mendimin në lidhje me atë se: i) dëshmitë kontabël të mbajtura nga ndërmarrja janë të mjaftushme, ii) shumat e prezentura janë në përputhje me | |

| | | |
|---|---|---|
| | dëshmitë kontabël të mbajtura.<br><br>8. Revizori: i) ka të drejtë për çasje të plotë në çfarëdo kohe në librat kontabël dhe dëshmitë kontabël, ii) mund të kërkojë informatë ose sqarimin që e konsideron si të nevojshëm në kryerjen e punës për të cilën është përgjegjes.<br><br>9. Cilido person që me vetëdije ose pakujdesi bën paraqitje që bartë ose tenton të bartë të dhëna ose sqarime që janë mashtruese, ç'orientuese ose falsifikuese në çështje të veçantë në raste të tilla bën shkelje ligjore.<br><br>10. Raporti i revizorit duhet të përmbajë emërin e revizorit, nënshkrimin dhe datën. Kur revizori është individ, raporti duhet të jetë i nënëshkruar nga ai/ajo. Kur revizori është firmë, raporti duhet të jetë i nënëshkruar nga revizori më i lartë me emër personal në emër të firmës së revizionit.<br><br>11. Pasqyrat financiare që i nënshtrohen revizionimit duhet të shpalosin emrin e revizorit dhe shumën e tarifave të paguara revizorit. | |
| 1. Pasqyrat financiare të shoqërive tregtare auditohen në pajtim me standardet ndërkombëtare të auditimit dhe në pajtim me nenin 5. pargrafi 1 të këtij Ligji, dorëzohen dhe publikohen në KKRF dhe një kopje dorëzohet në MTI, jo më vonë se më 30 prill të vitit vijues për vitin e kaluar.<br><br>2. Pasqyrat financiare të konsoliduara që auditohen në pajtim me Standardet ndërkombëtare të auditimit dhe në pajtim me nenin 5 paragrafi 3 të këtij Ligji, do të dorëzohen në KKRF dhe një kopje në MTI, jo më vonë se 30 qershor të vitit vijues. | 12. Pasqyrat financiare të personave të revizionuar në pajtim me standardet ndërkombëtare të revizionit dhe në pajtim me nenin 5. të këtij Ligji, dorëzohen nga një kopje në KKRF dhe në zyrën e regjistrimit të bizneseve, jo më vonë se më 30 qershor të vitit vijues për vitin e kaluar.<br><br>13. Pasqyrat financiare që i nënshtrohen revizionimit duhet të janë të publikuara në faqën e internetit të KKRF me qasje nga publiku. | 1. Pasqyrat financiare të shoqërive tregtare auditohen në pajtim me standardet ndërkombëtare të auditimit dhe në pajtim me nenin 5 paragrafi 1. të këtij ligji, dorëzohen dhe publikohen në KKRF dhemnjë kopje dorëzohet në MTI, jo më vonë se më 30 prill të vitit vijues për vitin e kaluar.<br><br>2. Pasqyrat financiare të konsoliduara që auditohen në pajtim me Standardet dërkombëtare të auditimit dhe në pajtim me nenin 5 paragrafi 3. të këtij ligji, do të dorëzohen në KKRF dhe një kopje në MTI, jo më vonë se 30 qershor të vitit vijues. |

| | | |
|---|---|---|
| **Neni 12**<br>**Ruajtja e dokumenteve**<br><br>1. Shoqëritë tregtare janë të obliguara të ruajnë librat kontabël sipas këtyre afateve:<br><br>1.1. Listat e pagave të ruhen në afat të pacaktuar;<br>1.2. Pasqyrat fianciare bashkë me librat ndihmëse në afat prej 10 vitesh;<br><br>1.3. Dokumentet kontabël në bazë të të cilave janë kryer regjistrimet ruhen së paku 6 vite.<br>1.4. Të njejtat afate zbatohen edhe për dokumentet elektronike (bartësit) dhe printimet e tyre.<br><br>**KREU III**<br><br>**KËSHILLI KOSOVAR PËR RAPORTIMIN FINANCIAR**<br><br>**Neni 13**<br>**Përbërja**<br><br>1. KKRF-ja është organ i pavarur, siç përcaktohet me dispozitat e këtij Ligji.<br><br>2. KKRF-ja përbëhet nga shtatë (7) anëtarë. Kryesuesi dhe anëtarët e tjerë të KKRF-së me propozim të institucionit emërohen nga Qeveria, të cilët do të përfaqësojnë institucionin si në vijim:<br><br>2.1. Një anëtar nga Banka Qendrore e Repubikës së Kosovës;<br>2.2. Një anëtar nga universitetet që ofrojnë arsimim superior universitar me lëndë mësimore në | **Neni 12**<br>**Ruajtja e dokumenteve**<br><br>1. Ndërmarrjet janë të obliguara të ruajnë librat kontabël sipas këtyre afateve:<br><br>1.1. Listat e pagave të ruhen në afat të pacaktuar;<br><br>1.2. Pasqyrat fianciare bashkë me librat kontabël në afat prej 10 vitesh;<br><br>1.3. Dëshmitë kontabël në bazë të të cilave janë kryer regjistrimet ruhen së paku 6 vite.<br>1.4. Të njëjtat afate zbatohen për dokumentet elektronike dhe për dokumente të shtypura.<br><br>**KREU III**<br><br>**KËSHILLI KOSOVAR PËR RAPORTIMIN FINANCIAR**<br><br>**Neni 13**<br>**Përbërja**<br><br>1. KKRF-ja është organ rregullativ profesional, i pavarur dhe vet-rregullues, siç përcaktohet me dispozitat e këtij Ligji. KKRF krijohet si institucion me përgjegjësi dhe llogaridhënie publike për standardet e raportimit financiar në Kosovë.<br><br>2. KKRF-ja përbëhet nga shtatë (7) anëtarë. Anëtarët e KKRF-së me propozim të institucioneve përkatëse emërohen nga Kuvendi i Kosovës. Anëtarët e KKRF përbehen nga përfaqësues të këtyre institucioneve:<br><br>2.1. Një anëtar nga Banka Qendrore e Repubikës së Kosovës;<br>2.2. Një anëtar nga universitetet që ofrojnë arsimim superior universitar me lëndë mësimore në kontabilitet | **Neni 12**<br>**Ruajtja e dokumenteve**<br><br>1. Shoqëritë tregtare janë të obliguara të ruajnë librat kontabël sipas këtyre afateve:<br><br>1.1. listat e pagave të ruhen në afat të pacaktuar;<br>1.2. pasqyrat financiare bashkë me librat ndihmëse në afat prej dhjetë (10) vitesh;<br>1.3. dokumentet kontabël në bazë të të cilave janë kryer regjistrimet ruhen së paku gjashtë (6) vite.<br>1.4. të njëjtat afate zbatohen edhe për dokumentet elektronike dhe të shtypur.<br><br>**KREU III**<br><br>**KËSHILLI I KOSOVËS PËR RAPORTIM FINANCIAR**<br><br>**Neni 13**<br>**Përbërja**<br><br>1. KKRF-ja është organ i pavarur profesional, siç përcaktohet me dispozitat e këtij ligji.<br><br>2. KKRF-ja përbëhet nga shtatë (7) anëtarë. Kryesuesi dhe anëtarët e tjerë të KKRF-së me propozim të institucionit emërohen nga Qeveria, të cilët do të përfaqësojnë institucionin si në vijim:<br><br>2.1. një (1) anëtar nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës;<br>2.2. një (1) anëtar nga universitetet që ofrojnë arsimim superior universitar me lëndë |

| | | |
|---|---|---|
| kontabilitet dhe auditim;<br>2.3. Një anëtar nga Ministria e Financave;<br>2.4. Një anëtar nga shoqatat profesionale e licencuar nga KKRF-ja;<br>2.5. Tre anëtarë me propozim nga OEK-ja nga komuniteti i biznesit që kanë njohuri dhe përvojë në financa dhe administrim biznesi; | dhe revizion<br>2.3. Një anëtar nga Ministria e Financave;<br>2.4. Nga një anëtar prej secilës shoqatë profesionale të miratuar nga KKRF-ja;<br>2.5. Nese është vetem një shoqatë profesionale e miratuar nga KKRF, tre anëtarë me propozim të OEK-ja nga komuniteti i biznesit të zgjedhur në bazë të konkursit me krietere që përputhen me përshkrimet në këtë ligj. Numri i të propozuarve nga OEK zvogëlohet në proporcion të drejtë me rritjen e numrit të shoqatave profesionale të miratuara nga KKRF;<br><br>3. Institucionet e cekura në paragrafin 13.2 dërgojnë tek MF të nominuarit e tyre më së largu 2 muaj nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji ose të krijimit të vendit të lirë në KKRF me përjashtim të universiteteve që ofrojnë arsimim superior universitar me lëndë mësimore në kontabilitet dhe revizion që duhet të dergojnë të nominuarin brenda afatit një mujor. Nëse këto universitete dështojnë në nominim, MF do të përcaktojë të nominuarin nga këto universitete. Emrat e të nominuarve MF i dërgon në Kuvend të Kosovës për emërim.<br><br>4. Anëtarët e KKRF-së emërojnë Kryesuesin e KKRF-së. | mësimore në kontabilitet dhe auditim;<br>2.3. një (1) anëtar nga Ministria e Financave;<br>2.4. një (1) anëtar nga shoqatat profesionale e licencuar nga KKRF-ja;<br>2.5. tre (3) anëtarë nga komuniteti i biznesit, që kanë njohuri dhe përvojë në financa dhe administrim biznesi; |
| 3. Kryesuesi i KKRF-së e as anëtarët nuk duhet të mbajnë funksione publike dhe të jenë të emëruar politik. | 5. Anëtarët e KKRF-së nuk duhet të mbajnë ose të kanë mbajtur në të kaluaren funksione politike ose partiake dhe të jenë të emëruar politik. | 3. Kryesuesi i KKRF-së e as anëtarët nuk duhet të mbajnë funksione publike dhe të jenë të emëruar politik. |
| 4. Anëtarët e KKRF-së do të emërohen për një periudhë tri (3) vjeçare, me të drejtë të riemërimit por nuk mund të shërbejnë më shumë se dy mandate. | 6. Anëtarët e KKRF-së do të emërohen për një periudhë tre (3) vjeçare, me të drejtë të riemërimit por nuk mund të shërbejnë më shumë se dy mandate. | 4. Anëtarët e KKRF-së do të emërohen për një periudhë tri (3) vjeçare, me të drejtë të riemërimit por nuk mund të shërbejnë më shumë se dy mandate. |
| 5. Personat e emëruar në KKRF duhet t'i plotësojnë të gjitha kriteret e mëposhtme të kualifikimit: | 7. Personat e emëruar në KKRF duhet t'i plotësojnë të gjitha kriteret e mëposhtme të kualifikimit: | 5. Personat e emëruar në KKRF duhet t'i plotësojnë të gjitha kriteret e mëposhtme të kualifikimit: |
| 5.1. Të kenë diplomë universitare në kontabilitet, financa, administrim të biznesit ose në juridik; | 7.1. Anëtarët e KKRF-së të kenë së paku 10 vjet përvojë pune të lidhur drejtpërdrejtë: i) në ushtrimin e | 5.1. të kenë diplomë universitare në kontabilitet, financa, administrim të biznesit ose në |

| | | |
|---|---|---|
| 5.2. Së paku 8 vjet përvojë pune relevante;<br>5.3. Reputacion të mirë dhe aftësi profesionale përkatëse; | profesionit të kontabilitetit/revizionit, ose ii) në angazhimet akademike në lëmin e kontabilitetit dhe revizionit. Anëtarët e Komisioneve të KKRF-së të kenë së paku 7 vjet përvojë pune të lidhur drejtpërdrejtë: i) në ushtrimin e profesionit të kontabilitetit/revizionit, ose ii) angazhimet akademike në lëmin e kontabilitetit dhe revizionit.<br><br>7.2. Reputacion të mirë. ndërshmëri dhe dëshmim të aftësive profesionale përkatëse;<br><br>8. Në punën e KKRF-së mund të angazhohen si anëtarë ekspertët e fushës përkatës pa kufizimet e cekura në paragrafin 14.4 mirëpo këta nuk kanë të drejtë vote. | juridik;<br>5.2. së paku tetë (8) vjet përvojë në fushën e kontabilitetit, financave dha auditimit;<br><br>5.3. reputacion të mirë dhe aftësi profesionale përkatëse; |
| 6. Qeveria me propozim të institucioneve sipas paragrafit 2 të këtij neni mund të shkarkoj Kryesuesin dhe anëtarët e KKRF-së për:<br><br>6.1. Shkelje të rëndë të ligjit apo humbje të aftësisë së punës;<br>6.2. Kur me aktgjykim të plotëfuqishëm është dënuar për vepër penale më shumë se 6 muaj;<br>6.3. Administrim ligjor, bankrotim apo likudim të detyrueshëm nga gjyqi apo autoriteti kompetent të cilësdo kompani që është në pronësi apo kontrollohet në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë nga ky anëtar;<br>6.4. Nëse është në lidhje martesore apo lidhje familjare deri në shkallën e dytë me një anëtar tjetër apo zyrtar të KKRF-së; | 8. MF me propozim të institucioneve sipas paragrafit 2 të këtij neni mund t'i propozojë Kuvendit të Kosovës shkakrkimin e një anëtari të KKRF-së për:<br><br>8.1. Shkelje të rëndë të ligjit apo humbje të aftësisë së punës;<br>8.2. Kur me aktgjykim të plotëfuqishëm është dënuar për çfardo shkelje ligjore me përjashtim të atyre për kundërvajtje;<br>8.3. Administrim ligjor, bankrotim apo likudim të detyrueshëm nga gjyqi apo autoriteti kompetent të cilësdo kompani që është në pronësi apo kontrollohet në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë nga anëtari;<br>8.4. Nëse është në lidhje martesore apo lidhje familjare deri në shkallën e dytë me një anëtar tjetër, ndonjë anëtar të Komisioneve të KKRF-së ose zyrtar të KKRF-së si dhe me përsonelin udhëheqës të shoqatave profesionale të mbikëqyra nga KKRF;<br>8.5 Kur institucioni që e ka nominuar anëtarin kërkon që të tërheq ose zëvendësojë të nominuarin e vet. | 6. Qeveria me propozim të institucioneve sipas paragrafit 2. të këtij neni mund të shkarkoj Kryesuesin dhe anëtarët e KKRF-së për:<br><br>6.1. shkelje të rëndë të ligjit apo humbje të aftësisë së punës;<br>6.2. kur me aktgjykim të plotfuqishëm është dënuar për vepër penale më shumë se gjashtë (6) muaj;<br>6.3. administrim ligjor, bankrotim apo likudim të detyrueshëm nga gjyqi apo autoriteti kompetent të cilësdo kompani që është në pronësi apo kontrollohet në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë nga ky anëtar;<br>6.4. nëse është në lidhje martesore apo lidhje familjare deri në shkallën e dytë me një (1) anëtar tjetër apo zyrtar të KKRF-së; |
| 7. Kryesuesi apo anëtari i KKRF-së, dorëheqjen me shkrim ia afron Qeverisë për procedurë të mëtejme. | 9. Në rast të nevojës për këtë, anëtari i KKRF-së dorëheqjen me shkrim ia afron MF për procedurë të mëtejme. | 7. Kryesuesi apo anëtari i KKRF-së, dorëheqjen me shkrim ia afron Qeverisë për procedurë të mëtejme. |

| | | |
|---|---|---|
| 8. Në rast pushimi nga puna, në rast vdekje apo dorëheqje nga KKRF-ja, Qeveria duhet të emërojë një anëtar të ri jo më vonë se 60 ditë. Anëtari i emëruar si më sipër do të shërbejë për periudhën e mbetur në vend të anëtarit që ka zëvendësuar dhe mund të rizgjidhet. | 10. Në rast pushimi nga puna, në rast vdekje apo dorëheqje nga KKRF-ja, Kuvendi i Kosovës duhet të mandatojë anëtarin e ri jo më vonë se 30 ditë nga dita e dërgimit të emrit në Kuvend. Anëtari i emëruar si më sipër do të shërbejë për periudhën e mbetur në vend të anëtarit që ka zëvendësuar dhe mund të rizgjidhet. | 8. Në rast pushimi nga puna, në rast vdekje apo dorëheqje nga KKRF-ja, Qeveria duhet të emërojë një anëtar të ri jo më vonë se gjashtëdhjetë (60) ditë. Anëtari i emëruar si më sipër do të shërbejë për periudhën e mbetur në vend të anëtarit që ka zëvendësuar dhe mund të rizgjidhet. |
| 9. Mbledhjet e KKRF-së mbahen vetëm nëse janë të pranishëm, së paku 5 anëtarë. Këshilli do të marrë vendim nëse votojnë shumica e thjeshtë e anëtarëve që janë të pranishëm. Në rast të votave të barabarta, vota e Kryesuesit të këshillit është vendimtare. | 11. Mbledhjet e KKRF-së mbahen vetëm nëse janë të pranishëm, së paku 5 anëtarë. Vendimet e Këshillit janë të plotfuqishme nëse votojnë shumica e thjeshtë e anëtarëve që janë të pranishëm. Në rast të votave të barabarta, vota e Kryesuesit të këshillit është vendimtare. | 9. Mbledhjet e KKRF-së mbahen vetëm nëse janë të pranishëm, së paku pesë (5) anëtarë. Këshilli do të marrë vendim nëse votojnë humica e thjeshtë e anëtarëve që janë të ranishëm. Në rast të votave të barabarta, vota e Kryesuesit të Këshillit është vendimtare. |
| 10. KKRF-ja mblidhet sa herë që të jetë e nevojshme, por jo më pak se dhjetë herë në vit. | 12. KKRF-ja mblidhet sa herë që të jetë e nevojshme, por jo më pak se dhjetë herë në vit. | 10. KKRF-ja mblidhet sipas nevojës. |
| 11. KKRF-ja do të mbështetet nga një numër i mjaftueshëm i personelit për ushtrimin e funksionit të tij siç është specifikuar në nenin 14.3.dhe 15. | 13. KKRF-ja do të mbështetet nga një numër i mjaftueshëm i personelit për ushtrimin e funksionit të tij siç është specifikuar në nenin 14.3.dhe 15. | 11. KKRF-ja do të mbështetet nga një numër i mjaftueshëm i personelit për ushtrimin e funksionit të tij siç është specifikuar në paragrafin 3. të nenit 14 dhe nenin 15 të këtij ligji. |
| 12. Çdo anëtar i KKRF-së merr një honorar për mbledhjet e mbajtura dhe do t’i kompensohen shpenzimet e arsyeshme të cilat janë krijuar si rezultat i takimeve ose punëve të KKRF-ës. Procedura e kompenzimit përcaktohet me akt nënligjor të nxjerr nga Ministri. | 14. Çdo anëtar i KKRF-së merr një honorar për mbledhjet e mbajtura dhe do t’i kompensohen shpenzimet tjera të arsyeshme të cilat janë krijuar si rezultat i takimeve ose punëve të KKRF-ës. | 12. Çdo anëtar i KKRF-së merr një honorar për mbledhjet e mbajtura dhe do t’i kompensohen shpenzimet e arsyeshme të cilat janë krijuar si rezultat i takimeve ose punëve të KKRF-ës. Procedura e kompensimit përcaktohet me akt nënligjor të nxjerr nga Ministri. |
| 13. KKRF-ja financohet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës, të hyrat vetanake dhe donacionet. | 15. KKRF-ja financohet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës, të hyrat vetanake dhe donacionet. Donacionet nuk mund të janë nga personat që i nënshtrohen kërkesave të këtij ligji. Për shpenzimet e KKRF-së të mbuluara nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës, KKRF vepron njëjtë sikur të gjitha njësitë tjera buxhetore konform rregullave dhe procedurave në fuqi.<br><br>16. Personeli i sekretariatit të KKRF-së do të mbajë | 13. KKRF-ja financohet nga Buxheti i Republikës së Kosovës, të hyrat vetanake dhe donacionet. |

| | | |
|---|---|---|
| | regjistrat dhe librat e kontabilitetit në pajtushmeri me standardet ndërkombëtare të miratuara dhe të aplikueshme për raportimin për Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës. Raporti financiar do të auditohet nga Zyra e Auditorit Gjeneral. | |
| 14. KKRF-ja për punën e vet nxjerr rregulloren e punës. | 17. KKRF-ja për punën e vet nxjerr rregulloret e punës. Rregullorja e punës duhet të mundësojë që mbledhjet e KKRF-së të jenë të hapura për pjesëmarrje nga të interesuarit ku të interesuarit nuk mund të marrin pjesë në diskutime mirëpo kanë të drejtë të bëjnë pyetje në fund të mbledhjes. | 14. KKRF-ja për punën e vet nxjerr rregulloren e punës. |
| **Neni 14**<br>**Funksionet dhe përgjegjësitë e KKRF-së** | **Neni 15**<br>**Funksionet dhe përgjegjësitë e KKRF-së** | **Neni 14**<br>**Funksionet dhe përgjegjësitë e KKRF-së** |
| 1. Funksionet e KKRF-së janë: | 1. Në funksion të përshkrimeve në paragrafin 13.1 të këtij ligji, KKRF ushtron rolin dhe funksionet siç janë përshkruar në paragrafët në vijim: | 1. Funksionet e KKRF-së janë: |
| 1.1. Të hartojë dhe aprovojë Standardet e Kontabilitetit të Kosovës në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit SNK/SNRF dhe direktivat relevante të BE-së; | 1.1. Harton dhe miraton Standardet Kosovare të Kontabilitetit në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit SNK/SNRF në fuqi si dhe të gjitha direktivat dhe Aquis Communautaire të BE-së në fuqi që janë përkatëse për raportimin financiar; | 1.1. të hartojë dhe aprovojë Standardet e Kontabilitetit të Kosovës në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit SNK/SNRF dhe direktivat relevante të BE-së; |
| 1.2. Mbikëqyrë dhe zbaton standardet e auditimit në përputhje me SNA dhe direktivat relevante të BE-së; | 1.2. Mbikëqyrë dhe zbaton standardet e auditimit në përputhje me SNA sidhe të gjitha direktivat dhe Aquis Communautaire të BE-së në fuqi që janë përkatëse për raportimin financiar; | 1.2. mbikëqyrë dhe zbaton standardet e auditimit në përputhje me SNA dhe direktivat relevante të BE-së; |
| 1.3. Licencimi dhe regjistrimi i auditorëve ligjor dhe firmave audituese dhe shoqatave profesionale të kontabilitetit dhe auditimit; | 1.3. Licencon dhe mbanë regjistrin e revizorëve të licensuar dhe firmave të revizionit të licensuara si dhe miraton dhe mban regjistrin e shoqatave profesionale të miratuara; | 1.3. licencimi dhe mbajtja e regjistrit të auditorëve dhe firmave audituese dhe shoqatave profesionale të kontabilitetit dhe auditimit**;** |
| 1.4. Adoptimi i standardeve të etikës profesionale, kualitetit të brendshëm të firmave audituese; | 1.4. Zbaton standardet e etikës profesionale dhe cilësinë e brendshme të revizorëve dhe firmave revizionuese në përputhje me SNA si dhe të gjitha direktivat dhe Aquis Communautaire të BE-së në fuqi që janë përkatëse për | 1.4. adoptimi i standardeve të etikës profesionale, kualitetit të brendshëm të firmave audituese; |

| | | |
|---|---|---|
| 1.5. Mbikëqyr edukimin e vazhdueshëm, sigurimin e kualitetit dhe sistemit disiplinor;<br><br>1.6. KKRF-ja mund të vendos të delegojë disa nga funksionet e saj të parapara sipas paragrafit 1, nënparagrafit 1.5. të këtij neni, shoqatës së licencuar profesionale | raportimin financiar;<br><br>1.5. Mbikëqyrë edukimin e vazhdueshëm, sisitemin e sigurimit të cilësisë dhe sistemin disiplinor për anëtarët e shoqatave profesionale të miratuara nga KKRF, të revizorëve dhe firmave revizionuese në përputhje me SNK/SNRF, SNR si dhe të gjitha direktivat dhe Aquis Communautaire të BE-së në fuqi që janë përkatëse për raportimin financiar;<br><br>1.6 KKRF u kërkon dhe shoqatat zbatojnë praktikën që u mundëson anëtarëve të shoqatës diskutim dhe shprehje të lirë të koncepteve, kuptimeve dhe përvojave në mënyrë të hapur dhe të papenguar mbi cilëndo qështje që ka të bëjë me profesionin e ushtruar. Shprehjet e lira të përshkruara në këtë paragraf duhet të ruhen deri në pesë vite dhe të janë të qasshme nga cilido anëtarë tjetër.<br><br>1.7. KKRF-ja mund të vendosë të delegojë disa nga funksionet e saj të parapara sipas paragrafit 1, nënparagrafit 1.5. të këtij neni, shoqatave profesionale të miratuara.<br><br>1.8. Në ushtrimin e rolit dhe të funksioneve të përshkruara në paragrafët 15.1.1 deri në 15.1.7 organizon diskutim publik, i bënë publike dhe i ruan këto diskutime për një periudhë pesë vjeçare | 1.5. mbikëqyrë edukimin e vazhdueshëm, sigurimin e kualitetit dhe sistemit disiplinor;<br><br>2. KKRF-ja nostrifikon certifikatat ndërkombëtare të auditorëve dhe kontabilistëve.<br><br>3. Kandidatët që kanë tituj dhe kualifikime tjera kanë të drejtë në njohjen e këtyre titujve dhe kualifikimeve në bazë të kërkesës për njohje pranë shoqatës së miratuar në Kosovë. Secila shoqatë e miratuar duhet që të ketë skemë të miratuar nga KKRF, për njohjen e kualifikimeve dhe titujve tjerë nga ato të ofruara nga vetë shoqata në mënyrë që kandidatët e interesuar të mund të ushtrojnë të drejtën e |

| | | |
|---|---|---|
| | | përshkruar në këtë paragraf. |
| 2. Për kryerjen e funksioneve dhe përgjegjësive të veta sipas këtij Ligji, Këshilli mbështetet nga një sekretari administrative (në tekstin vijues "Sekretaria") e përbërë prej udhëheqësit dhe nëpunësve të tjerë administrativ. | 2. Për kryerjen e funksioneve dhe përgjegjësive të veta sipas këtij Ligji, Këshilli mbështetet nga një sekretari administrative (në tekstin vijues "Sekretaria") e përbërë prej udhëheqësit dhe nëpunësve të tjerë administrativ. | 4. Për kryerjen e funksioneve dhe përgjegjësive të veta sipas këtij Ligji, Këshilli mbështetet nga një sekretari administrative (në tekstin vijues "Sekretaria") e përbërë prej udhëheqësit dhe nëpunësve të tjerë administrativ. |
| 3. Udhëheqësi dhe nëpunësit e Sekretarisë zgjidhen dhe shkarkohen me pëlqim të kryesuesit të KKRF-së sipas dispozitave ligjore përkatëse për shërbimin civil. | 3. Udhëheqësi dhe nëpunësit e Sekretarisë zgjidhen dhe shkarkohen nga KKRF në përputhje me dispozitat ligjore përkatëse për shërbimin civil. | 5. Udhëheqësi dhe nëpunësit e Sekretarisë zgjidhen dhe shkarkohen sipas Ligjit për Shërbimin Civil. |
| 4. Obligohet KKRF-ja që të prezentoj Pasqyrat financiare për Shoqëritë tregtare nëse një gjë e tillë kërkohet nga Administrata Tatimore e Kosovës. | 4. Obligohet KKRF-ja që të prezentojë Pasqyrat financiare të personave nëse një gjë e tillë kërkohet nga Administrata Tatimore e Kosovës. | 6. Obligohet KKRF-ja që të prezantoj pasqyrat financiare për Shoqëritë tregtare nëse një gjë e tillë kërkohet nga Administrata Tatimore e Kosovës. |
| **Neni 15**<br>**Komisionet e KKRF-së** | **Neni 14**<br>**Komisionet e KKRF-së** | **Neni 15**<br>**Komisionet e KKRF-së** |
| 1. KKRF-ja do të caktojë komisione sipas nevojës për të siguruar zbatimin e standardeve ndërkombëtare përkatëse të BE-s "Aquis Communautaire" duke përfshirë direktivat nr.78/660/EEC, direktiva nr. 83/349/EEC dhe direktiva nr. 84/253/EEC të BE-së. | 1. KKRF-ja do të caktojë komisione sipas nevojës për të siguruar zbatimin e standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar të përshkruara në paragrafët 15.1. | 1. KKRF-ja do të caktojë komisione sipas nevojës për të siguruar zbatimin e standardeve ndërkombëtare përkatëse të BE-s "Acquis Communautaire" duke përfshirë direktivat nr. 78/660/EEC, nr. 83/349/EEC dhe nr. 4/253/EEC të BE-së. |
| 2. KKRF-ja duhet të ketë më së paku këto komisione për:<br>2.1. Standardet e kontabilitetit;<br>2.2. Standardet profesionale;<br>2.3. Licencim të auditorëve ligjor, firmave audituese dhe shoqatave profesionale të kontabilitetit dhe auditimit;<br>2.4. Hetime dhe disiplinë;<br>2.5. Sigurimin e cilësisë, dhe<br>2.6. Komisionet tjera sipas nevojes. | 2. KKRF-ja sipas vleresimit te nevojave krijon komision dhe që si minimum duhet të ketë së paku këto komisione:<br>2.1. Komisioni për standardet e kontabilitetit;<br>2.2. Komisioni për standardet e revizionit;<br>2.3. Komisioni për licencim e revizorëve, firmave revizionuese dhe shoqatave profesionale të kontabilitetit dhe revizionit;<br>2.4. Komisioni për hetime dhe disiplinë;<br>2.5. Komisioni për sigurimin e cilësisë; | 2. KKRF-ja duhet të ketë këto komisione, për:<br>2.1. standardet e kontabilitetit dhe auditimit;<br>2.2. standardet profesionale dhe sigurimin e cilësisë;<br>2.3. licencim të auditorëve, firmave audituese dhe shoqatave profesionale të kontabilitetit dhe auditimit;<br>2.4. hetime dhe disiplinë; dhe<br>2.5. komisione tjera të përkohshme sipas nevojës. |
| 3. Anëtarët e këtyre komisioneve do të jenë individë të | 3. Anëtarët e këtyre komisioneve do të jenë individë të | 3. Anëtarët e këtyre komisioneve do të jenë |

| | | |
|---|---|---|
| kualifikuar me njohuri profesionale të theksuar në fushën që ka të bëjë me funksionet dhe qëllimet e komisioneve. KKRF-ja mund të kërkojë drejtpërdrejtë ndihmë nga profesionistët me kualifikim të lartë në fushën e audimit por të cilët së paku tri (3) vite nuk kanë qen të përfshirë në sistemin e mbikqyrjes, nuk kanë kryer auditime ligjore, nuk kanë pasur të drejtë vote në firmat e auditimit, nuk kanë qenë anëtarë të trupit administrativ apo menaxhues të auditimit, nuk kanë qenë të punësuar apo bashkëpunëtor me ndonjë firmë të auditimit, për t'u bërë anëtarë të komisioneve sipas pragrafit 2 nënparagrafit 2.4 dhe 2.5 të këtij neni. | kualifikuar dhe me njohuri profesionale të theksuar në fushën që ka të bëjë me funksionet dhe qëllimet e komisioneve.<br><br>4. Anëtarë të komisioneve me të drejtë vote nuk mund të janë personat të cilët së paku në vitin e fundit para zgjedhjes: i) kanë qenë të angazhuar si anëtar me të drejtë vote në institucionet e mbikqyrjes së raportimit financiar, ii) kanë kryer revizione si revizor të licensuar, iii) kanë pasur të drejtë vote në firmat e revizionit, iv) kanë qenë anëtarë të trupit administrativ apo menaxhues të revizionit dhe firmave revizionuese, iv) kanë qenë të punësuar apo bashkëpunëtorë me ndonjë firmë të revizionit.<br><br>5. Në punën e komisioneve mund të angazhohen si anëtar ekspertët e fushës përkatës pa kufizimet e cekura në paragrafin 14.4 mirëpo këta nuk kanë të drejt vote. | individë të kualifikuar me njohuri profesionale të theksuarnë fushën që ka të bëjë me funksionet dhe qëllimet e komisioneve. KKRF-ja mund të kërkojë drejtpërdrejtë ndihmë nga profesionistët me kualifikim të lartë në fushën e auditmit por të cilët së paku tri (3) vite nuk kanë qenë të përfshirë në sistemin e mbikëqyrjes, nuk kanë kryer auditime, nuk kanë pasur të drejtë vote në firmat e auditimit, nuk kanë qenë anëtarë të trupit administrativ apo menaxhues të auditimit, nuk kanë qenë të punësuar apo bashkëpunëtor me ndonjë firmë të auditimit, për t'u bërë anëtarë të komisioneve sipas paragrafit 2 nën-paragrafit 2.4 dhe 2.5 të këtij neni. |
| **Neni 16**<br>**Bashkëpunimi me Shoqatat e Kontabilistëve** | **Neni 16**<br>**Mbikëqyrja e Shoqatave Profesionale të Kontabilistëve dhe Revizorëve të Kosovës** | **Neni 16**<br>**Mbikëqyrja e Shoqatave të kontabilistëve dhe auditorëve** |
| 1. KKRF-ja u drejtohet shoqatave të licencuara profesionale të kontabilitetit që të ofrojnë këto dokumente: | 1. KKRF-ja në procesin e mbikëqyrjes së shoqatave të miratuara mund t'u kërkojë dokumentët dhe materialet të cilat i konsideron si të nevojshme në kuadër të rolit dhe përgjegjësive të përshkruara në paragrafin 13.1. Dokumentat dhe materialet e kërkuara kanë të bëjnë me: | 1. KKRF-ja kërkon nga shoqatat e licencuara profesionale të kontabilisteve dhe auditorëve që të prezantojnë këto dokumente: |
| 1.1. Një kopje të "Kodit të etikës";<br><br>1.2. Raport të shoqatës që tregon programin për sigurimin e cilësisë;<br>1.3. Raportin në lidhje me rezultatet e hetimeve të shoqatës duke përfshirë edhe procedurat disiplinore dhe<br>1.4. Raport se si programi për kualitetin e shoqatës i plotëson kërkesat e direktivave të auditmit ligjor të Bashkimit Evropian. | 1.1. Planprogramin dhe materialet e trajnimit dhe të testimit të kadidatëve për kontabilistë të Çertifikuar dhe Revizor;<br>1.2 Materialet në lidhje me Kodin Etik të cilit i nënshtrohen anëtarët e shoqatës;<br>1.3. Materialet që kanë të bëjnë me programin dhe procedurat e zbatuara për anëtarët në lidhje me sigurimin e cilësisë;<br><br>1.4. Materialet që kanë të bëjnë me procedurat e zbatuara për anëtarë në lidhje me hetimet dhe masat diciplinore; | 1.1. një kopje të "Kodit të etikës";<br>1.2. raport të shoqatës që tregon programin për sigurimin e cilësisë;<br>1.3. raportin në lidhje me rezultatet e hetimeve të shoqatës duke përfshirë edhe procedurat disiplinore dhe<br>1.4. raport se si programi për kualitetin e shoqatës i plotëson kërkesat e direktivave të auditmit të Bashkimit Evropian. |

| | | |
|---|---|---|
| | 1.5. Materialet që kanë të bëjnë me programin dhe procedurat për sigurimin e cilësisë së vetë shoqatës në përgjigje të plotësimit të standardeve në përputhje me SNK/SNRF, SNR si dhe të gjitha direktivat dhe Aquis Communautaire të BE-së në fuqi që janë përkatëse për raportimin financiar;<br><br>1.6. Dokumentat dhe materialet e brendshme të shoqatës si Statuti, Programi dhe nën-aktet tjera ku Statuti dhe aktet tjera të mbrendshme të shoqatës duhet t'u mundësojnë anëtarëve që të kënë qasje të plotë në të gjithë dokumentat e brendshëm të shoqatës në rastet kur 10% ose më tëpër anëtarë e kërkojnë një gjë të tillë.<br><br>1.7. Përveç dokumentave dhe materialeve të përshkruara në paragrafët 16.1.1 deri 16.1.7, KKRF mund të kërkojë cilindo dokument ose material që e konsideron të nevojshmëm në kuadër të rolit dhe përgjegjësive të përshkruara në paragrafin 13.1;<br><br>2. Së paku një herë në tre vite, apo edhe më shpesh nëse KKRF konsideron të nevojshme, bën mbikëqyrjen e zbatimit nga shoqata e miratuar të standardëve dhe procedurave të përshkrura në dokumentat e prezentuar tek KKRF dhe të miratuar nga KKRF. Për këtë mikëqyrje, KKRF angazhon profesionistë me përvojat më të larta nga Kosova, ose profesionist nga vendi që zbaton standarde profesionale të nivelit të njëjtë me përshkrimet në këtë ligj ose nivel më të larta se përshkrimet në këtë ligj, ose, Shoqatë profesionale të kontabilitetit dhe revizionit të miratuar nga vendi që zbaton standarde profesionale të nivelit të njëjtë me përshkrimet në këtë ligjë ose nivel më të larta se përshkrimet në këtë ligj.<br><br>3. KKRF mban të drejtën që të verifikojë dhe inspektojë cilindo dokument, material, proces ose aktivitet të shoqatës së miratuar të cilin e konsideron të aryeshëm në kuadër të rolit dhe përgjegjësive të përshkruara në këtë ligj dhe të ndërmarrë cilendo masë ose veprim që e konsideron të nevojshëm për ushtrimin rolit dhe përgjegjësisë në bazë | |

| | | |
|---|---|---|
| | të këtij ligji. | |
| **Neni 17**<br>**Raportimi i KKRF-së** | **Neni 17**<br>**Raportimet dhe publikimet e KKRF-së** | **Neni 17**<br>**Raportimi i KKRF-së** |
| 1. KKRF-ja pas 31 dhjetorit të çdo viti dhe para 30 qershorit, duhet që t'i dorëzojë Qeverisë raport për: | 1. KKRF në secilin vit kalendarik pas 31 dhjetorit dhe para 30 qershorit, duhet që t'i dorëzojë në Kuvend për miratim: | 1. KKRF-ja pas 31 dhjetorit të çdo viti dhe deri më 30 qershor, duhet që t'i dorëzojë Qeverisë raport për: |
| 1.1. Punët e KKRF-së dhe të komisioneve të tij; | 1.1. Planin dhe progrramin e punës së paku për periudhën e ardhshme njëvjeçare janar-dhjetor, por mund të jetë edhe për periudha më afatëgjate. Planet dhe programet e dorëzuara duhet të përmbajnë projeksione që përfshijnë ato financiare dhe buxhetore; | 1.1. punët e KKRF-së dhe të komisioneve të tij;<br>1.2. arritjet e objektivave të caktuara për vitin fiskal që ka përfunduar; |
| 1.2. Arritjet e objektivave të caktuara për vitin fiskal që ka përfunduar; | 1.2. Raportin njëvjeçar përmbleshës janar-dhjetor që pasqyron punën dhe aktivietet e KKRF-së dhe Komisioneve të saj. Raporti duhet të pasqyrojë rezultatet dhe vështirësitë në raport me planin dhe programin e miratuar nga Kuvendi; | |
| 2. KKRF publikonë raportin. | 2. Raportet e miratuara nga Kuvendi i Kosovës, KKRF i publikon në faqën e vet të internetit. | 2. KKRF publikon raportin vjetor të punës. |
| 3. KKRF-ja lëshon deklarata me shkrim për politikat, aktet nënligjore që do të ndihmojnë në zbatimin e standardeve të kontabilitetit dhe të auditimit në Kosovë, standardeve profesionale dhe të edukimit, kërkesat për pavarësinë e auditorit duke përfshirë këtu edhe rishikimet e jashtme për siguri të cilësisë dhe procedurat disiplinore. | 3. KKRF-ja publikon në formë të shkruar dokumentat mbi politikat, aktet nënligjore e të ngjajshme që do të ndihmojnë në: i) zbatimin e standardeve të kontabilitetit dhe të revizionit në Kosovë, ii) standardet profesionale për edukim, trajnim dhe testim, iii) pavarësinë e revizorit përfshirë rishikimet e punës nga jashtë, kërkesat për sigurim të cilësisë, iv) procedurat dhe masat disiplinore, v) dokumente dhe materiale tjera në kuadër të kompetencave në bazë të këtij ligji; | 3. KKRF-ja publikon deklarata me shkrim për politikat, aktet nënligjore që do të ndihmojnë në zbatimin e standardeve të kontabilitetit dhe të auditimit në Kosovë, standardeve profesionale dhe të edukimit, kërkesat për pavarësinë e auditorit, duke përfshirë këtu edhe rishikimet e jashtme për siguri të cilësisë dhe procedurat disiplinore. |
| 4. KKRF-ja u lëshon udhëzues shoqërive tregtare për të zbatuar standarde të caktuara (SNK/SNRF) të përshtatshme për shoqëritë tregtare. | 4. KKRF publikon udhëzues administrativ për ndërmarrjet në lidhje me zbatimin e standardeve të raportimit financiar si SNK/SNRF, SNR dhe të ngjajshme. | 4. KKRF-ja publikon udhëzues shoqërive tregtare për të zbatuar standarde të caktuara (SNK/SNRF), të përshtatshme për shoqëritë tregtare. |
| | 5. KKRF publikon përmbledhjet e të gjitha diskutimeve dhe | |

| | | |
|---|---|---|
| | qëndrimeve të anëtarëve të vetë KKRF-së dhe komisioneve dhe të gjitha dokumentat dhe materialet tjera që janë në interes të profesionistëve dhe publikut.<br><br>6. KKRF publikon regjistrin mbi revizorët e licensuar, firmat revizionuese dhe shoqatat profesionale të miratuara. | |
| 5. Standardet, politikat dhe aktet nënligjore tashmë të lëshuara nga Bordi Kosovar mbi Standardet për Raportim Financiar, do të jenë në fuqi derisa të ndryshohen nga KKRF-ja.<br><br>6. Standardet e kontabilitetit dhe auditimit si dhe aktet nënligjore dhe dokumentet tjera të lëshuara nga KKRF-ja do të publikohen në faqen e internetit të KKRF-së, sipas ligjit nr. 02/L-37 për Përdorimin e Gjuhëve.<br><br>7. KKRF-ja mbanë regjistrin publik të të gjithë auditorëve ligjor dhe firmave ligjore të auditimit. | 7. Standardet, politikat dhe aktet nënligjore tashmë të lëshuara nga Bordi Kosovar mbi Standardet për Raportim Financiar, do të jenë në fuqi derisa të ndryshohen nga KKRF-ja.<br><br>8. Dokumentat dhe materialet e ndryshme KKRF-ja do t'i publikojë në faqen e internetit të KKRF-së, në përputhje me ligjin Nr. 02/L-37 për Përdorimin e Gjuhëve. Dokumentat dhe materialet e publikuara janë në qasje të lirë për të gjithë të interesuarit | 5. Standardet, politikat dhe aktet nënligjore tashmë të lëshuara nga Bordi Kosovar mbi Standardet për Raportim Financiar, do të jenë në fuqi derisa të ndryshohen nga KKRF-ja.<br><br>6. Standardet e kontabilitetit dhe auditimit si dhe aktet nënligjore dhe dokumentet tjera të lëshuara nga KKRF-ja, do të publikohen në faqen e internetit të KKRF-së, sipas Ligjit nr. 02/L-37 për përdorimin e gjuhëve.<br><br>7. KKRF-ja mbanë regjistrin publik të të gjithë auditorëve dhe firmave të auditimit. |
| **Neni 18**<br>**Ruajtja e fshehtësisë së të dhënave** | **Neni 18**<br>**Ruajtja e fshehtësisë së të dhënave** | **Neni 18**<br>**Ruajtja e fshehtësisë së të dhënave** |
| 1. KKFR-ja dhe i gjithë personeli duhet t'i ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme që të mbrojnë nga përdorimet e paautorizuara dhe bërjen publike të të dhënave që atyre u janë dhënë me mirëbesim.<br><br>2. Në lidhje me paragrafin 1 të këtij neni bërja publike e të dhënave lejohet nëse:<br><br>1.1. Është kërkuar me ligj në Kosovë;<br>1.2. Bëhet me qëllim që t'i mundësojë një autoriteti apo një personi në një vend jashtë Kosovës, të kryej një funksion, detyrë që korrespondon me atë të KKRF-së; dhe<br><br>1.3. I bëhet një shoqate të licencuar profesionale të | 1. KKFR dhe i gjithë personeli nën mbikëqyrje të KKRF-së duhet t'i ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme që të mbrojnë nga përdorimet e paautorizuara dhe bërja publike e të dhënave të atyre që i kanë dhënë në mirëbesim.<br><br>2. Në lidhje me paragrafin 1 të këtij neni bërja publike e të dhënave lejohet nëse:<br><br>1.1. Është kërkuar me ligjet e Kosovës;<br>1.2. Bëhet me qëllim që t'i mundësojë një autoriteti apo një personi nga një vend jashtë Kosovës, të kryej një funksion, detyrë për të cilën është kontraktuar nga KKRF. Në raste të tilla, institucioni ose individi nuk mund t'i shpalosë ose t'i përdorë për qëllime tjera nga ato të kontraktuara me KKRF; dhe | 1. KKFR-ja dhe i gjithë personeli duhet t'i ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme që të mbrojnë nga përdorimet e paautorizuara dhe bërjen publike të të dhënave që atyre u janë dhënë me mirëbesim.<br><br>2. Në lidhje me paragrafin 1. të këtij neni bërja publike e të dhënave lejohet nëse:<br><br>2.1. është kërkuar me ligj në Kosovë;<br>2.2. bëhet me qëllim që t'i mundësojë një autoriteti apo një personi në një vend jashtë Kosovës, të kryej një funksion, detyrë që korrespondon me atë të KKRF-së; dhe<br>2.3. i bëhet një shoqate të licencuar profesionale të kontabilitetit dhe auditimit me qëllim të |

| | | |
|---|---|---|
| kontabilitetit dhe auditimit me qëllim të ushtrimit të funksioneve të saj. | 1.3. I bëhet një shoqate të licencuar profesionale të kontabilitetit dhe revizionit në kuadër të ushtrimit të funksioneve të saj. | ushtrimit të funksioneve të saj. |
| **Neni 19**<br>**Ndalimi i konfliktit të interesave dhe keqpërdorimit të të dhënave** | **Neni 19**<br>**Ndalimi i konfliktit të interesave dhe keqpërdorimit të të dhënave** | **Neni 19**<br>**Ndalimi i konfliktit të interesave dhe keqpërdorimit të të dhënave** |
| 1. Anëtarët e KKRF-së në pajtim me këtë nen duhet të informojnë me shkrim kryesuesin e KKRF-së, për çdo konflikt të interesit apo përfitim financiar që anëtari e ka apo e përfiton në një kompani e cila vepron në Kosovë apo në një biznes në Kosovë. | 1. Anëtarët e KKRF-së dhe të Komisioneve në pajtim me këtë nen duhet të informojnë me shkrim KKRF-në, për çdo konflikt të interesit apo përfitim financiar që anëtari e ka apo e përfiton në një ndërmarrje e cila vepron në Kosovë apo në një biznes në Kosovë. | 1. Anëtarët e KKRF-së në pajtim me këtë nen duhet të informojnë me shkrim kryesuesin e KKRF-së, për çdo konflikt të interesit apo përfitim financiar që anëtari e ka apo e përfiton në një kompani e cila vepron në Kosovë apo në një biznes në Kosovë. |
| 2. Kjo vlen kur një anëtar: | 2. Paragrafi 19.1 vlen kur një anëtar: | 2. Kjo vlen kur një anëtar: |
| 2.1. Merr pjesë në marrjen e vendimit në lidhje me një çështje për KKRF-në apo komisionet e tij, dhe<br><br>2.2. Ka apo përfiton interesa financiare të drejtpërdrejta apo të tërthorta, të çfarëdo lloji tjetër, që mund të jenë pengesë në zbatimin e funksioneve e detyrave në lidhje me vendosjen e çështjes. | 2.1. Merr pjesë në marrjen e vendimit në lidhje me një çështje në kuadër të rolit dhe përgjegjësive të KKRF-së dhe komisioneve të tij, dhe<br>2.2. Ka apo përfiton interesa financiare të drejtpërdrejta apo të tërthorta, të çfarëdo lloji tjetër, që mund të jënë pengesë në zbatimin ose funksionimin e qështjeve për të cilin merret vendimi. | 2.1. merr pjesë në marrjen e vendimit në lidhje me një çështje për KKRF-në apo komisionet e tij, dhe<br>2.2. ka apo përfiton interesa financiare të drejtpërdrejta apo të tërthorta, të çfarëdo lloji tjetër, që mund të jenë pengesë në zbatimin e funksioneve e detyrave në lidhje me vendosjen e çështjes. |
| 3. Kur Kryesuesi i KKRF-së ka konflikt interesi, atëherë Qeveria njoftohet me shkrim. | 3. Kur Kryesuesi i KKRF-së ka konflikt interesi, atëherë njoftohen me shkrim anëtarët tjerë të KKRF-së dhe MF. | 3. Kur Kryesuesi i KKRF-së ka konflikt interesi, atëherë Qeveria njoftohet me shkrim. |
| 4. Kryesuesi i KKRF-së duhet të merr vendim nëse anëtari duhet apo nuk duhet të marr pjesë në vendosjen e çështjes dhe anëtari duhet të sillet në pajtueshmëri me udhëzim të tillë. | 4. KKRF duhet të merrë vendim nëse anëtari duhet apo nuk duhet të merrë pjesë në vendimarje në lidhje me çështjet ku anëtari duhet të sillet në pajtueshmëri me përshkrimet në këtë ligj. | 4. Kryesuesi i KKRF-së duhet të merr vendim nëse anëtari duhet apo nuk duhet të marr pjesë në vendosjen e çështjes dhe anëtari duhet të sillet në pajtueshmëri me udhëzimin e tillë. |
| 5. Në rastin kur një anëtar është kryesues, ai duhet të shpalos në rast se ka një interes personal në një çështje të personave të ndërlidhur, dhe ai apo ajo nuk duhet që të merr pjesë në përcaktimin e çështjes, përpos në rastin kur ka pëlqimin e të gjithëve që ai të merr pjesë. | 5. Në rastin kur anëtari i KKRF-së është kryesues, ai duhet të shpalos rastet kur ka interes personal në çështje që kanë të bëjnë me palët e ndërlidhura, dhe në raste të tilla ai apo ajo nuk duhet që të merr pjesë në diskutimin dhe marrjen e vendimit atë çështje. | 5. Në rastin kur një anëtar është kryesues, ai duhet të shpalos në rast se ka një interes personal në një çështje të personave të ndërlidhur, dhe ai apo ajo nuk duhet që të merr pjesë në përcaktimin e çështjes, përpos në rastin kur ka pëlqimin e të gjithëve që ai të merr pjesë. |

| | | |
|---|---|---|
| 6. Personeli i Sekretariatit duhet të paraqesë me shkrim tek kryetari çdo interes direkt apo indirekt financiar, apo çfarëdo interesi tjetër, në një çështje e cila kërkon vendim nga KKRF-ja apo nga komisionet e tjera, ashtu që të ndalojë pjesëmarrjen e tij apo saj në hulumtimet që janë të lidhura me atë çështje. | 6. Personeli i Sekretariatit duhet të paraqesë me shkrim tek KKRF çdo interes direkt apo indirekt financiar, apo çfarëdo interesi tjetër, në një çështje e cila kërkon vendimarrje nga KKRF-ja apo nga komisionet e tjera, ashtu që të evitojë pjesëmarrjen e tij apo saj në hulumtimet për atë qështje ose aktivitetet që janë të lidhura me atë çështje. | 6. Personeli i Sekretariatit duhet të paraqesë me shkrim tek kryetari çdo interes direkt apo indirekt financiar, apo çfarëdo interesi tjetër, në një çështje e cila kërkon vendim nga KKRF-ja apo nga komisionet e tjera, ashtu që të ndalojë pjesëmarrjen e tij apo saj në hulumtimet që janë të lidhura me atë çështje. |
| **KREU IV** | **KREU IV** | **KREU IV** |
| **KUALIFIKIMET PËR KONTABILISTËT E CERTIFIKUAR** | **KUALIFIKIMET PËR KONTABILISTËT E CERTIFIKUAR** | **KUALIFIKIMET PËR KONTABILISTËT E CERTIFIKUAR** |
| **Neni 20**<br>**Kualifikimi** | **Neni 20**<br>**Titujt dhe Kualifikimet** | **Neni 20**<br>**Kualifikimi** |
| 1. Personi që është kualifikuar si kontabilist i certifikuar nga një shoqatë e licencuar profesionale kontabiliteti dhe auditimi dhe vazhdon të jetë anëtar me status të rregullt pranë një shoqate profesionale të kontabilitetit dhe auditimit ka të drejtë të përdor titullin “kontabilist i certifikuar”. | 1. Personi që është kualifikuar si kontabilist i çertifikuar nga shoqata e miratuar profesionale dhe që vazhdon të jetë anëtar me status të rregullt pranë asaj shoqate ka të drejtë të përdor titullin “Kontabilist i Çertifikuar”. | 1. Personi që është kualifikuar si kontabilist i certifikuar nga një shoqatë e licencuar profesionale kontabiliteti dhe auditimi dhe vazhdon të jetë anëtar me status të rregullt pranë një shoqate profesionale të kontabilitetit dhe auditimit ka të drejtë të përdor titullin “kontabilist i certifikuar”. |
| 2. Një shoqatë e licencuar profesionale e kontabilitetit dhe auditimit mund të certifikojë një person si kontabilist të certifikuar vetëm nëse ai/ajo person i ka përmbushur plotësisht kërkesat për kualifikim që jepen në paragrafin 3 dhe 4 të këtij neni. | 2. Shoqata e miratuar profesionale e kontabilitetit dhe revizionit mund të çertifikojë personin si kontabilist të çertifikuar vetëm nëse ai/ajo i ka përmbushur plotësisht kërkesat për kualifikim që jepen në paragrafin 3 dhe 4 të këtij neni. | 2. Një shoqatë e licencuar profesionale e kontabilitetit dhe auditimit mund të certifikojë një person si kontabilist të certifikuar vetëm nëse ai/ajo person i ka përmbushur plotësisht kërkesat për kualifikim që jepen në paragrafin 3. dhe 4. të këtij neni. |
| 3. Kandidatëve për kontabilist të certifikuar do t’u kërkohet të kenë tri (3) vite përvojë pune në lëmin e kontabilitetit, të kenë marrë diplomë universiteti, trajnimin dhe të kenë kaluar provimin e certifikimit për këtë qëllim. | 3. Kandidatit për kontabilist të çertifikuar do t’i kërkohet të kanë tri (3) vite përvojë pune në lëmin e kontabilitetit dhe të ketë të kompletuar programin e trajnimit dhe testimit nga shoqata profesionale e miratuar nga KKRF. Shoqata profesionale e miratuar mund t’u ofrojë kadidatëve të saj programin e përvojës së punës, të trajnimit dhe të testimit vetëm në përputhje me programet që i ka të miratuara nga KKRF. | 3. Kandidatët për kontabilist të certifikuar duhet të kenë diplomë universiteti në fushën e ekonomisë dhe biznesit, tri (3) vite përvojë pune në lëmin e kontabilitetit, të kenë marrë, dhe të kenë kaluar provimin e certifikimit për këtë qëllim**.** |

| | | |
|---|---|---|
| 4. Sipas paragrafit 3 të këtij neni, arsimimi profesional dhe trajnimi do të jenë në pajtim me standardet e kualifikimeve të arsimit profesional, aftësitë profesionale, aftësimi për njohuri teorike dhe praktike të përcaktuara në Standardet Ndërkombëtare të Edukimit të FNK-së si dhe në direktivat relevante të Komisionit Evropian për këtë qëllim. | 4. Duke marrë parasysh përshkrimet në paragrafin 3 të këtij neni, arsimimi profesional dhe trajnimi duhet të jenë në pajtim me standardet për arsimim dhe kualifikim profesional, shkathtësitë profesionale, dhe aftësimit me njohuri teorike dhe praktike të cilat janë të përcaktuara me Standardet Ndërkombëtare të Edukimit të FNK-së si dhe me direktivat dhe Aquis Communautaire të BE-së për këtë qëllim. | 4. Arsimimi profesional për kontabilist të certifikuar duhet të jetë në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Edukimit të FNK-së si dhe me direktivat relevante të Komisionit Evropian për këtë qëllim**.** |
| | 5. Përveç titullit “Kontabilist i Çertifikuar” të përshkruar në paragrafët 3 dhe 4 të këtij neni, KKRF mund të miratojë edhe tituj tjerë të kontabilistëve të ofruar nga ndonjë shoqatë tjetër profesionale e miratuar nga KKRF. Në të gjitha rastet e miratimit të titujve të kontabilistëve, KKRF do të zbatojë përshkrimet e paragrafit 4 të këtij neni.<br><br>6. Në kompletimin e programit të trajnimit dhe testimit nga shoqata profesionale e miratuar nga KKRF kandidati ka të drejtë t’i nënështrohet testimit pa patur obligim përcjelljen e ligjeratave në klasë.<br><br>7. Përveç në bazë të përshkrimeve në paragrafët 20.1 deri 20.6 të këtij neni, KKRF miraton edhe tituj për kontabilistë në bazë të përshkrimeve në paragrafin 21. 2. | |
| 5. Për zbatimin e paragrafit 1 të këtij neni KKRF- ja, nxjerr akt nënligjor. | 7. Për zbatimin e paragrafëve 1 deri 7 të këtij neni, KKRF, nxjerr akte të veçanta nënligjore. | 5. Për zbatimin e paragrafit 1. të këtij neni KKRF- ja, nxjerr akt nënligjor. |
| **KREU V**<br><br>**LICENCIMI I AUDITORËVE LIGJOR**<br><br>**Neni 21**<br>**Kushtet** | **KREU V**<br><br>**LICENCIMI I REVIZORËVE**<br><br>**Neni 21**<br>**Kushtet** | **KREU V**<br><br>**LICENCIMI I AUDITORËVE**<br><br>**Neni 21**<br>**Kushtet** |
| 1. KKRF-ja licencon auditorë ligjor personat që plotësojnë kriteret e mëposhtëm: | 1. KKRF-ja shpall si “Revizor të Licensuar” individët që plotësojnë kriteret e mëposhtëm: | 1. KKRF-ja licencon auditorë personat që plotësojnë kriteret e mëposhtëm: |

| | | |
|---|---|---|
| 1.1. Ata që kanë marrë pjesë në arsim profesional dhe trajnim dhe të cilët kanë kaluar provimet e parapara në paragrafin 3 të nenit 20;<br>1.2. Ata që kanë marr pjesë në arsimin profesional dhe trajnim dhe kanë kaluar provimet për auditorë;<br>1.3. Ata që kanë tri vite përvojë pune nën mbikqyrjen e një auditori ligjor;<br>1.4. Ata që janë anëtar të një shoqate të aprovuar profesionale të kontabilistëve dhe auditorëve në Kosovë;<br>1.5. Ata që plotësojnë standardet më të larta të integritetit dhe kompetencës profesionale dhe që kanë reputacion të mirë. | 1.1. Individët që kanë marrë titull kontabiliteti të miratuar nga KKRF sipas përshkrimeve të nenit 20;<br><br>1.2. Individët që kanë kaluar provimet për revizor të ofruar nga shoqata e miratuar;<br>1.3. Ata që kanë tri vite përvojë pune nën mbikqyrjen e një revizori të licensuar;<br>1.4. Ata që janë anëtar të një shoqate të miratuar profesionale të kontabilistëve dhe revizorëve në Kosovë;<br>1.5. Ata që plotësojnë standardet më të larta të ndershmërisë dhe kompetencës profesionale dhe që kanë reputacion të mirë. | 1.1. ata që kanë marrë pjesë në arsim profesional dhe të cilët kanë kaluar provimet e parapara në paragrafin 3. të nenit 20 të këtij ligji;<br>1.2. ata që kanë marr pjesë në arsimin profesional dhe kanë kaluar provimet për auditorë;<br>1.3. ata që kanë tri (3) vite përvojë pune nën mbikëqyrjen e një auditori;<br>1.4. ata që janë anëtar të një shoqate të licencuar profesionale të kontabilistëve dhe auditorëve në Kosovë ose jashtë saj;<br>1.5. ata që plotësojnë standardet më të larta të integritetit dhe kompetencës profesionale dhe që kanë reputacion të mirë. |
| | 2. Kandidatët që kanë tituj dhe kualifikime tjera qoftë nga Kosova qoftë nga vende tjera kanë të drejtë në njohjen e ketyre titujve dhe kualifikimeve në bazë të kërkesës për njohje pranë shoqatës së miratuar në Kosovë. Secila shoqatë e miratuar duhet që të ketë skemë të miratuar nga KKRF për njohjen e kualifikimeve dhe titujve tjerë nga ato të ofruara nga vetë shoqata në mënyrë që kandidatët e inetersuar të mund të ushtrojnë të drejtën e përshkruar në këtë paragrafë. | |
| 2. Në përputhje me nënparagrafin 1.1. dhe 1.2. të këtij neni, arsimimi profesional dhe trajnimi do të bëhen në pajtim me standardet e arsimit profesional, aftësitë profesionale, aftësimi për njohuri teorike dhe praktike të përcaktuara në Standardet Ndërkombëtare të Edukimit të FNK-së si dhe në direktivën 8 të Komisionit Evropian për këtë qëllim. | 3. Në përputhje me nënparagrafin 1.1. dhe 1.2. të këtij neni, arsimimi profesional dhe trajnimi bëhen në pajtim me standardet për arsimim dhe kualifikim profesional, shkathtësitë profesionale, dhe aftësimit me njohuri teorike dhe praktike të cilat janë të përcaktuara me Standardet Ndërkombëtare të Edukimit të FNK-së si dhe me direktivat dhe Aquis Communautaire të BE-së për këtë qëllim. | 2. Në përputhje me nën-paragrafët 1.1. dhe 1.2. të paragrafit 1. të këtij neni, arsimimi profesional për auditor të certifikuar, duhet të jetë në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Edukimit të FNK, si dhe me Direktivën 8 të Komisionit Evropian, për këtë qëllim. |
| 3. KKRF-ja me akt nënligjor përcakton kushtet specifike të licensimit të auditorëve ligjor sipas nenit 26 të këtij ligji. | | 3. KKRF-ja me akt nënligjor përcakton kushtet specifike të licencimit të auditorëve sipas nenit 26 të këtij ligji. |
| 4. KKRF-ja përcakton kritere të aplikueshme të licencojë auditorë të huaj që të ndërmarrin auditime ligjore në Kosovë, të cilët duhet t'i plotësojnë kërkesat minimale të të dhënave në paragrafin 1 të këtij neni. | 4. KKRF shpall revizorët e huaj si "Revizor të Licensuar" në Kosovë individët që përmbushin kërkesat e përshkrimeve në paragrafët 21.1 deri 21.3 | 4. KKRF-ja përcakton kritere të aplikueshme të licencojë auditorë të huaj që të ndërmarrin auditime në Kosovë, të cilët duhet t'i plotësojnë kërkesat minimale të të dhënave në paragrafin 1. |

| | | |
|---|---|---|
| | 5. KKRF shpall “Firmë e Huaj Revizioni e Licensuar” në rast të përmbushjes së këtyre kritereve:<br><br>5.1. Ka zyrë në Kosovë;<br><br>5.2. Themelon ndërmarrje të regjistruar në Kosovë, e cila ka të punësuar së paku një individ me titull “Revizor i Licensuar” në bazë të këtij Ligji;<br><br>5.3. Është e menaxhuar plotësisht nga individë me titull “Revizor i Licensuar” që janë anëtarë të shoqates së miratuar profesionale në Kosovë. | të këtij neni. |
| 5. KKRF-ja licencon firma auditimi vendore ose të huaja nëse:<br><br>5.1. Ka zyrë në Kosovë;<br>5.2. Krijon një organizatë biznesi (ndërmarrje afariste) të regjistruar në Kosovë, e cila ka të paktën dy auditorë ligjor të licencuar sipas këtij Ligji;<br>5.3. Është e menaxhuar nga auditorë ligjor që janë anëtarë të një shoqate të licencuar profesionale të kontabilistëve dhe auditorëve në Kosovë.<br><br>6. KKRF-ja aprovon një firmë auditimi të huaj apo vendore vetëm nëse është në përputhshmëri me ligjin mbi shoqëritë tregtare dhe biznesi është i regjistruar si:<br>6.1. Një biznes individual me auditorin ligjor si udhëheqës;<br>6.2. Një ortakëri e përgjithshme ose e kufizuar me të gjithë partnerët udhëheqës;<br>6.3. Një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me shumicën e të drejtave të votimit të mbajtur nga udhëheqësit kështu që, nën statutin e firmës, t’iu mundësohet partnerëve kyç t’i drejtojnë politikat e tyre të përgjithshme apo ta ndryshojnë statutin e saj.<br><br>7. Personat të cilët janë të licencuar nga KKRF-ja si | 6. KKRF shpall “Firmë Revizioni e Licensuar” e huaj ose vendore vetëm nëse është themeluar në përputhje me ligjin mbi shoqëritë tregtare dhe ka struturën e pronësisë dhe menaxhimit si më poshtë:<br><br>6.1. Biznes individual me Revizor të Licensuar si udhëheqës;<br>6.2. Ortakëri e përgjithshme ose e kufizuar me të gjithë partnerët udhëheqës që janë Revizorë të Licensuar;<br>6.3. Ndërmarrje me përgjegjësi të kufizuar me së paku ¾ e të drejtave të votimit të mbajtur nga individë me titull “Revizor i Licensuar” dhe plotësisht e menaxhuar nga individ me titull “Revizor i Licensuar”. | 5. KKRF-ja licencon firma auditimi vendore ose të huaja nëse:<br><br>5.1. ka zyrë në Kosovë;<br>5.2. krijon një organizatë biznesi të regjistruar në Kosovë, e cila ka të paktën dy (2) auditorë të licencuar sipas këtij ligji;<br>5.3. është e menaxhuar nga auditorë që janë anëtarë të një shoqate të licencuar profesionale të kontabilistëve dhe auditorëve në Kosovë.<br><br>6. KKRF-ja aprovon një firmë auditimi të huaj apo vendore vetëm nëse është në përputhshmëri me Ligjin mbi shoqëritë tregtare dhe biznesi është i regjistruar si:<br>6.1. një biznes individual me auditorin si udhëheqës;<br>6.2. një ortakëri e përgjithshme ose e kufizuar me të gjithë partnerët udhëheqës;<br>6.3. një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me shumicën e të drejtave të votimit të mbajtur nga udhëheqësit kështu që, nën statutin e firmës, t’iu mundësohet partnerëve kyç t’i drejtojnë politikat e tyre të përgjithshme apo ta ndryshojnë statutin e saj.<br><br>7. Personat të cilët janë të licencuar nga KKRF- |

| | | |
|---|---|---|
| auditorë të huaj ligjor, mund të bëhen udhëheqës të një firme audituese të regjistruar në Kosovë, nëse ata mbajnë së paku shumicën e të drejtave të votimit në bordin menaxhues ose t'i mbajnë të drejtat e tilla që nën statutin e firmës iu mundëson atyre t'i drejtojnë politikat e tyre të përgjithshme apo ta ndryshojnë statutin e saj. | | ja si auditorë të huaj, mund të bëhen udhëheqës të një firme audituese të regjistruar në Kosovë, nëse ata mbajnë së paku shumicën e të drejtave të votimit në bordin menaxhues ose t'i mbajnë të drejtat e tilla që nën statutin e firmës iu mundëson atyre t'i drejtojnë politikat e tyre të përgjithshme apo ta ndryshojnë statutin e saj. |
| 8. KKRF-ja do të revokojë licencën e një firme të huaj ose vendore të auditimit, ose auditorit i cili është i licencuar në pajtueshmëri me këtë Ligj në çdo kohë nëse firma e auditimit ose auditori ligjor nuk do të jetë më anëtar i një shoqate të licencuar profesionale të kontabilitetit dhe auditimit në Kosovë, ose e shkel pavarësinë e auditorit, etikën dhe kërkesat për sigurimin e cilësisë të përcaktuara nga KKRF-ja. | 7. KKRF revokon licencën firmës të huaj ose vendore të revizionit, ose të idividit revizor i licensuar nëse individët revizor të licensuar nuk do të jetë më anëtarë të shoqatës së miratuar profesionale të kontabilitetit dhe auditimit në Kosovë, ose e shkelë pavarësinë e auditorit, etikën dhe kërkesat për sigurimin e cilësisë të përcaktuara nga KKRF. | 8. KKRF-ja do të revokojë licencën e një firme të huaj ose vendore të auditimit, ose auditorit i cili është i licencuar në pajtueshmëri me këtë ligj në çdo kohë, nëse firma e auditimit ose auditori nuk do të jetë më anëtar i një shoqate të licencuar profesionale të kontabilitetit dhe auditimit në Kosovë, ose e shkel pavarësinë e auditorit, etikën dhe kërkesat për sigurimin e cilësisë të përcaktuara nga KKRF-ja. |
| | 8. KKRF me akte nënligjore përcakton dhe shpall kushtet tjera specifike prë licensim të revizorëve dhe firmave të revizionit në përputhje me përshkrimet në këtë ligj. | |
| **KREU VI** | **KREU VI** | **KREU VI** |
| **SHOQATAT PROFESIONALE TË KONTABILITETIT DHE AUDITIMIT DHE INSTITUCIONEVE ARSIMORE** | **SHOQATAT PROFESIONALE TË KONTABILITETIT DHE REVIZIONIT** | **SHOQATAT PROFESIONALE TË KONTABILITETIT DHE AUDITIMIT DHE INSTITUCIONEVE ARSIMORE** |
| **Neni 22**<br>**Statusi i shoqatave** | **Neni 22**<br>**Statusi i shoqatave** | **Neni 22**<br>**Statusi i shoqatave** |
| 1. Një shoqatë profesionale e kontabilitetit dhe auditimit është organizatë jo fitim prurëse e themeluar sipas ligjit për organizatat joqeveritare. Përbëhet nga anëtarët e saj, ka kapacitete dhe i nënshtrohet këtij Ligji, me të drejta, fuqi dhe përgjegjësi të një personi juridik. Shoqata profesionale e kontabilitetit do të jetë e licencuar nga KKRF-ja, me përmbushjen e këtyre kushteve: | 1. Shoqata profesionale e kontabilitetit dhe revizionit është organizatë jo fitimprurëse e themeluar sipas ligjit për organizatat joqeveritare. Përbëhet nga anëtarët e saj, fuqizohet nga ky ligj dhe i nënshtrohet këtij ligji, me të drejta dhe përgjegjësi të personit juridik. Shoqata profesionale e kontabilitetit dhe revizionit do të jetë e miratuar nga KKRF, me përmbushjen e këtyre kushteve:<br><br>1.1 KKRF është e bindur se shoqata ka zotësinë për | 1. Shoqata profesionale e kontabilitetit dhe auditimit, licencohet nga KKRF, me përmbushjen e këtyre kushteve:<br><br>1.1. KKRF-ja duhet të sigurohet se shoqata ka përmbushur të gjitha kërkesat sipas këtij ligji si dhe ka plotësuar të gjitha standardet, udhëzimet dhe rekomandimet e lëshuara nga FNK-ja, për shoqatat anëtare të saj. |

| | | |
|---|---|---|
| 1.1. dëshmi se është anëtare e Federatës Ndërkombëtare të Kontabilitetit;<br>1.2. Një shoqatë profesionale e licencuar nga BKSRF-ja para miratimit të këtij Ligji, do të marrë parasysh një shoqatë profesionale të licencuar për qëllim të zbatimit të këtij ligji, për aq kohë sa kjo shoqatë të jetë anëtare e IFAC;<br>1.3. KKRF-ja nxjerr kritere për licencimin e përhershëm dhe të përkohshëm të shoqatave profesionale.<br><br>2. Së paku një herë në pesë vite apo edhe më shpesh nëse KKRF-ja përcakton shoqatat profesionale të kontabilitetit dhe auditimit, do të angazhojë një kontabilist profesional nga një vend që ka arsim, provime dhe kualifikim profesional ose një Shoqatë profesionale në fushën e Kontabilitetit dhe Auditimit dhe kërkesë të përvojës të ngjashme me ato të përcaktuara me nenet e këtij Ligji për të mbikqyrur zbatimin e standardeve dhe procedurave siç përcaktohet me këtë Ligj.<br><br>3. Institucionet arsimore të cilat në kuadër të vetë kanë degë të kontabilitetit dhe auditimit, inkurajohen që për programet mësimore të marrin pëlqimin nga KKRF-ja. | plotësimin e kërkesave e këtij Ligji dhe standardeve, udhëzimeve dhe rekomandimeve të lëshuara nga FNK-ja për shoqatat anëtarë të saj;<br>1.2. KKRF është e bindur se shoqata ka zotësinë që të sigurojë se anëtarët do të veprojnë në pajtueshmëri me Kodin e sjelljes profesionale në pajtim më Kodin e etikës së FNK-së.<br><br>2. Shoqata profesionale e miratuar nga KKRF-ja merr të drejtën përgjegjësinë për të çertifikuar kontabilistët dhe revizorët dhe do të mbikëqyrë trajnimin praktik të kandidatëve që dëshirojnë të bëhen kontabilistë të çertifikuar dhe revizorë të licensuar, të testojë që ky trajnim është i nivelit të duhur që siguronë kompetencë profesionale dhe ndërshmëri te këtyre kandidatëve. Të gjitha këto të drejta dhe përgjegjësi shoqata i ushtron në përputhje me miratimin nga KKRF.<br><br>2. Vetëm shoqatat e miratuara nga KKRF mund të bartin titullin “Shoqatë Profesionale e Miratuar për Kontabilitet dhe Revizion” | 1.2. KKRF-ja duhet të sigurohet se anëtaret e çdo shoqate veprojnë në pajtueshmëri me kodin e sjelljes profesionale dhe me kodin e etikës së FNK-së.<br><br>2. Së paku një herë në pesë (5) vite apo edhe më shpesh nëse KKRF-ja përcakton shoqatat profesionale të kontabilitetit dhe auditimit, do të angazhojë një kontabilist profesional nga një vend që ka arsim, provime dhe kualifikim profesional ose një Shoqatë profesionale në fushën e Kontabilitetit dhe Auditimit dhe kërkesë të përvojës të ngjashme me ato të përcaktuara me nenet e këtij ligji për të mbikëqyrur zbatimin e standardeve dhe procedurave siç përcaktohet me këtë ligj.<br><br>3. KKRF-ja obligohet të bashkëpunojë me institucionet arsimore në fushën e kontabilitetit dhe auditimit. |

| | | |
|---|---|---|
| **KREU VII**<br><br>**MASAT ADMINISTRATIVE**<br><br>**Neni 23**<br>**Masat administrative**<br><br>1. KKRF-ja ka për detyrë të mbikëqyrë zbatimin e këtij ligji.<br><br>2. Në rast të konstatimit të shkeljes së këtij ligji, komisioni për hetim dhe disiplinë mund t'i jep vërejtje personit, shoqatës tregtare, përkatësisht shoqatës profesionale që është përgjegjëse për shkeljen e Ligjit dhe të merr masa konkrete për të siguruar zbatimin e Ligjit.<br><br>3. Komisioni vendos gjoba administrative në rastet vijuese:<br><br>3.1. Me gjobë prej € 5.000 deri në € 25.000 ndëshkohet subjekti i cili nuk dorëzon pasqyrat financiare të përcaktuara në nenin 11;<br>3.2. Me gjobë prej € 5.000 deri € 10.000 ndëshkohet subjekti i cili nuk dorëzon pasqyrat financiare të audituara të përcaktuara në nenin 11, në afatin e paraparë në nenin 12;<br>3.3. Me gjobë prej € 3.000 deri € 5.000 ndëshkohet subjekti i cili nuk zbaton standardet e kontabilitetit, përkatësisht të auditimit të përcaktuara nga Komisioni konform këtij Ligji;<br>3.4. Me gjobë prej € 10.000 deri € 30.000 ndëshkohet shoqata profesionale e kontabilitetit dhe e auditimit e cila licencon kontabilistë dhe auditor në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, si dhe inicohet procedura për marrjen e licencës;<br>3.5. Në rastet e përcaktuara në paragrafin 3 nënparagrafët 1.1. dhe 1.2., përveç subjektit, ndëshkohet me gjobë prej € 200 deri € 1.000 edhe | **KREU VII**<br><br>**MASAT ADMINISTRATIVE**<br><br>**Neni 23**<br>**Masat administrative**<br><br>1. KKRF-ja ka për detyrë të mbikëqyrë zbatimin e këtij ligji.<br><br>2. Në rast të konstatimit të shkeljes së këtij ligji, komisionet përkatëse mund t'i jepin vërejtje personit, ndërmarrjes dhe shoqatës profesionale të miratuar dhe të marrin masa tjera konkrete për të siguruar zbatimin e Ligjit.<br><br>3. Komisionet përkatëse vendosin gjoba administrative në rastet vijuese:<br><br>3.1. Me gjobë prej € 5.000 deri në € 150.000 ndëshkohet subjekti i cili nuk dorëzon pasqyrat financiare të përcaktuara në nenin 11 dhe nenin 12 të këtij ligji;<br>32. Me gjobë prej € 3.000 deri € 150.000 ndëshkohet subjekti i cili nuk zbaton standardet e kontabilitetit, përkatësisht të revizionit të përcaktuara nga ky Ligji;<br>3.3. Me gjobë prej € 10.000 deri € 100.000 ndëshkohet shoqata e miratuar profesionale e kontabilitetit dhe revizionit e cila lëshon tituj për kontabilistë dhe revizor në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji;<br>3.4. Në rastet e përcaktuara në paragrafët 3.1 deri 3.3, përveç subjektit, ndëshkohet me gjobë prej € 200 deri € 20.000 edhe personi përgjegjës të ndërmarrjes, përkatësisht të shoqatës profesionale të miratuar. | **KREU VII**<br><br>**MASAT NDËSHKIMORE**<br><br>**Neni 23**<br>**Masat ndëshkimore**<br><br>1. KKRF-ja ka për detyrë të mbikëqyrë zbatimin e këtij ligji.<br><br>2. Në rast të konstatimit të shkeljes së këtij ligji, komisioni për hetim dhe disiplinë mund t'i jep vërejtje personit, shoqatës tregtare, përkatësisht shoqatës profesionale që është përgjegjëse për shkeljen e Ligjit dhe të merr masa konkrete për të siguruar zbatimin e ligjit.<br><br>3. Komisioni vendos gjoba në rastet vijuese:<br><br>3.1. me gjobë prej pesëmijë (5000) deri njëzetepesëmijë (25000) Euro ndëshkohet subjekti i cili nuk dorëzon pasqyrat financiare të përcaktuara në nenin 11 të këtij ligji;<br>3.2. me gjobë prej pesëmijë (5000) deri dhjetëmijë (10000) Euro ndëshkohet subjekti i cili nuk dorëzon pasqyrat financiare të audituara të përcaktuara në nenin 11, në afatin e paraparë në nenin 12 të këtij ligji;<br>3.3. me gjobë prej tremijë (3000) deri pesëmijë (5000) ndëshkohet subjekti i cili nuk zbaton standardet e kontabilitetit, përkatësisht të auditimit të përcaktuara nga Komisioni konform këtij ligji;<br>3.4. me gjobë prej dhjetëmijë (10000) deri tridhjetëmijë (30000) Euro ndëshkohet shoqata profesionale e kontabilitetit dhe e auditimit e cila licencon kontabilistë dhe auditor në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, si dhe |

| | | |
|---|---|---|
| personi përgjegjës për udhëheqjen e ndërmarrjes, përkatësisht të shoqatës profesionale. | | iniciohet procedura për marrjen e licencës;<br>3.5. në rastet e përcaktuara në nën-paragrafët 1.1. dhe 1.2., të këtij paragrafi përveç subjektit, ndëshkohet me gjobë prej dyqind (200) deri njëmijë (1000) Euro edhe personi përgjegjës për udhëheqjen e ndërmarrjes, përkatësisht të shoqatës profesionale. |
| 4. Nëse një subjekt, shoqatë profesionale ose person kryen në mënyrë të përsëritur një prej veprave të përcaktuara në paragrafin 2 të këtij neni, Komisioni mund të shqiptojë gjobë deri në pesë herë të gjobës së paraparë për veprën në fjalë. | 4. Nëse personat ose subjektet e përshkruar në paragrafët 3.1 deri 3.3 kryejnë në mënyrë të përsëritur një prej veprave të përcaktuara në paragrafët 2 dhe 3 të këtij neni, Komisionet përkatëse mund të shqiptojnë gjobë deri në pesë herë të gjobës së paraparë në këto nene. | 4. Nëse një subjekt, shoqatë profesionale ose person kryen në mënyrë të përsëritur një prej veprave të përcaktuara në paragrafin 2. të këtij neni, Komisioni mund të shqiptojë gjobë deri në pesë herë të gjobës së paraparë për veprën në fjalë. |
| 5. Komisioni ka për detyrë të jep arsyetim të hollësishëm për vërejtjet dhe gjobat e shqiptuara sipas paragrafit 1, 2 dhe 3 të këtij neni. | 5. Komisioni ka për detyrë të jepë arsyetim të hollësishëm për vërejtjet dhe gjobat e shqiptuara sipas paragrafët 1deri 4 të këtij neni. | 5. Komisioni ka për detyrë të jep arsyetim të hollësishëm për vërejtjet dhe gjobat e shqiptuara sipas paragrafit 1., 2. dhe 3. të këtij neni. |
| 6. Nëse një gjobë e shqiptuar nga Komisioni për Hetim dhe Disiplinë nuk është paguar, KKRF-ja do të inicojë procedurën në gjykatën kompetente. | 6. Nëse një gjobë e shqiptuar nga Komisionet përkatëse nuk është paguar, KKRF ndërmerr procedura juridike në gjykatat kompetente. | 6. Nëse një gjobë e shqiptuar nga Komisioni për Hetim dhe Disiplinë nuk është paguar, KKRF-ja do të iniciojë procedurën në gjykatën kompetente. |
| 7. Palët e pakënaqura me vendimin e komisionit mund të paraqesin ankesë në afatin prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së vendimit KKRF-së. | 7. Palët e pakënaqura me vendimin e komisionit përkatës mund të paraqesin ankesë tek KKRF në afatin prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të vendimit të komisionit përkatës. | 7. Palët e pakënaqura me vendimin e komisionit mund të paraqesin ankesë në afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e marrjes së vendimit KKRF-së. |
| 8. KKRF-ja duhet të nxjerr vendim lidhur me ankesen e paraqitur. | 8. Në shqyrtimin e ankesës, KKRF angazhon persona të tjerë nga ata të cilat kanë marrë pjesë në marrjen e vendimit. Këta përsona të angazhuar duhet t'i përmbushin kërkesat për angazhim në KKRF dhe komisione të përshkruara në këtë ligj. KKRF duhet të nxjerr vendim të ri lidhur me ankesen e paraqitur. | 8. KKRF-ja duhet të nxjerr vendim lidhur me ankesën e paraqitur. |
| 9. Të gjitha gjobat e mbledhura sipas këtij neni do të derdhen në Buxhetin e Republikës së Kosovës. | 9. Të gjitha gjobat e mbledhura sipas këtij neni do të derdhen në Buxhetin e Republikës së Kosovës.<br><br>10. KKRF me akte nënligjore përcakton kriteret, procedurat | 9. Të gjitha gjobat e mbledhura sipas këtij neni do të derdhen në Buxhetin e Republikës së Kosovës. |

| | | |
|---|---|---|
| | dhe kushtet tjera specifike në bazë cilave komisionet përkatëse marrin masa ndëshkuese.<br><br>11. KKRF publikon në faqën e vet të internetit: i) të gjitha aktet nënligjore dhe dokumentat tjerë që janë bazë për marrjen e vendimeve ndëshkeuse, ii) të gjitha raportet examinuese, vlerësuese etj. si dhe kopjen e vendimit ndëshkues të komisioneve përkatëse, iii) kopjet e ankesave dhe materialet tjera të dorëzuara nga pala ankuese, iv) vendimin përfundimtar të KKRF-së. | |
| **KREU VIII** | **KREU VIII** | **KREU VIII** |
| **DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE DHE KALIMTARE** | **DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE DHE KALIMTARE** | **DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE DHE KALIMTARE** |
| **Neni 24**<br>**Dispozitat shfuqizuese** | **Neni 24**<br>**Dispozitat shfuqizuese** | **Neni 24**<br>**Dispozitat shfuqizuese** |
| 1. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, shfuqizohen të gjitha dispozitat ligjore që janë në kundërshtim me këtë ligj. | 1. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, shfuqizohen të gjitha dispozitat ligjore që janë në kundërshtim me këtë ligj. | 1. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, shfuqizohen të gjitha dispozitat ligjore që janë në kundërshtim me këtë ligj. |
| 2. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji shfuqizohet Rregullorja nr.2001/30, për themelimin e Bordit të Raportimit Financiar të Kosovës si dhe të Regjimit të Raportimit Financiar të organizatave afariste. | 2. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji shfuqizohet Rregullorja nr.2001/30, për themelimin e Bordit të Raportimit Financiar të Kosovës si dhe të Regjimit të Raportimit Financiar të organizatave afariste. | 2. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji shfuqizohet Rregullorja nr. 2001/30, për themelimin e Bordit të Raportimit Financiar të Kosovës si dhe të Regjimit të Raportimit Financiar të organizatave afariste. |
| 3. Pas hyrjes në fuqi të këtij ligji BKSRF-ja, do të përfundoj së ekzistuari dhe të gjitha pasuritë, burimet njerëzore, të drejtat dhe detyrimet do të kalojn në KKRF. | 3. Pas hyrjes në fuqi të këtij ligji BKSRF-ja, do të përfundojë së ekzistuari dhe të gjitha pasuritë, burimet njerëzore, të drejtat dhe detyrimet do të kalojnë në KKRF. | 3. Pas hyrjes në fuqi të këtij ligji BKSRF-ja, do të përfundoj së ekzistuari dhe të gjitha pasuritë, burimet njerëzore, të drejtat dhe detyrimet do të kalojnë në KKRF. |
| 4. Pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, Sekretaria e themeluar me Rregulloren nr.2001/30, transferohet në Sekretari në kuadër të KKRF me drejtat, përgjegjësitë dhe gjithë pasuritë e tyre. | 4. Pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, Sekretaria e themeluar me Rregulloren nr.2001/30, transferohet në kuadër dhe nën mbikëqyrje të KKRF-së me të gjtiha të drejtat, përgjegjësitë, detyrimet dhe pasuritë e tyre. | 4. Pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, Sekretaria e themeluar me Rregulloren nr. 2001/30, transferohet në Sekretari në kuadër të KKRF me drejtat, përgjegjësitë dhe gjithë pasuritë e tyre. |
| 5. Ky ligj nuk do të aplikohet për Bankën Qendrore të | 5. Ky ligj nuk do të aplikohet për Bankën Qendrore të | 5. Ky ligj nuk do të aplikohet për Bankën |

| | | |
|---|---|---|
| Republikës së Kosovës dhe të gjitha organizatave të licencuara nga BQK-ja sipas legjislacionit në fuqi.<br><br>**Neni 25**<br>**Dispozita e përkohshme**<br><br>Auditorët që janë të licencuar nga BKSRF-ja, përpara se të hyjë në fuqi ky ligj, do t'i nënshtrohen dispozitave të përkohshme të përcaktuara nga BKSRF-ja sipas kritereve për licencim sipas ligjit në fuqi.<br><br>**Neni 26**<br>**Zbatimi**<br><br>KKRF-ja nxjerrë akte nënligjore për zbatimin e këtij Ligji. | Republikës së Kosovës dhe të gjitha subjekteve nën mbikëqyrje të BQK-sëh sipas legjislacionit në fuqi.<br><br>**Neni 25**<br>**Dispozita e përkohshme**<br><br>Të gjitha licencat, titujt, kualifikimet, të drejtat dhe obligimet si dhe kërkesat ligjore për standarde dhe raportime financiare që janë të përshkruara në ligjet tjera të deritanishme në fuqi do të vlejnë deri në hyrjen në fuqi të këtij ligji dhe të zbatimit të këtij ligji sipas afateve të përshkruara në nenin 26.<br><br>**Neni 26**<br>**Zbatimi**<br><br>1. KKRF ka të drejtë të nxjerrë, shpallë dhe bëjë publike akte nënligjore dhe dokumenta tjerë që i konsideron të nevojshëm për të mundësuar zbatimin e këtij Ligji.<br><br>2. Në përmbushje të përshkrimit të Kreut III të këtij ligji, me qëllim të themelimit të KKRF-së, institucionet e cekura në paragrafët e Kreut III duhet që duke u përmbajtur kërkesave të përshkruara në paragrafët e Kreut III të përmbyllin nominimin dhe dergimin e emrave në Kuvend të Kosovës më së largu 60 ditë kalendarike nga dita e hyrjes në fuqi e këtij ligji. Kuvendit i kërkohet që të marrë vendim në miratimin e emërimit të KKRF-së më së largu 30 ditë kalendarike nga marrja e emërave.<br><br>3. Në vitin e parë të themelimit, KKRF përgadit një program pune për periudhën deri në fund të vitit të parë kalendarik që përfshin edhe planifikimet financiare dhe buxhetore. MF detyrohet që në bazë të këtij plani financiar dhe buxhetor të bëjë derdhjen e mjeteve për financim tëKKRF-së.<br><br>4. Obligohet KKRF që më së largu një vit kalendarik nga hyrja në fuqi e këtij ligji të marrë në pronësi dhe të | Qendrore të Republikës së Kosovës dhe të gjitha organizatave të licencuara nga BQK-ja sipas legjislacionit në fuqi.<br><br>**Neni 25**<br>**Dispozita e përkohshme**<br><br>Auditorët që janë të licencuar nga BKSRF-ja, përpara se të hyjë në fuqi ky ligj, do t'i nënshtrohen dispozitave të përkohshme të përcaktuara nga BKSRF-ja, sipas kritereve për licencim sipas ligjit në fuqi.<br><br>**Neni 26**<br>**Zbatimi**<br><br>KKRF-ja nxjerrë akte nënligjore për zbatimin e këtij ligji. |

| | | |
|---|---|---|
| | konsideroj si të vetat të gjitha licencat, titujt, kualifikimet, të drejtat dhe obligimet si dhe të gjitha kërkesat, të drejtat dhe obligimet ligjore për standarde dhe raportime financiare që janë të përshkruara në ligjet tjera para hyrjes në fuqi të këtij ligji. Në këtë kuadër, mbrenda këtij afati, duhet që KKRF t'i rishikojë aktet nënligjore, dokumentat tjerë të lëshuar nga BKSRF përfshi të gjitha licencat, titujt, kualifikimet, të drejtat dhe obligimet si dhe të gjitha kërkesat, të drejtat dhe obligimet ligjore për standarde dhe raportime financiare dhe t'i shpallë e t'i bëjë publike aktet e veta nënligjore dhe dokumentat tjerë që do të mundësojnë zbatim të plotë të përshkrimeve të këtij ligji.<br><br>5. Obligohet KKRF që jo më larg se një vit kalendarik nga krijimi i tij të kompletojë procedurat për rishikimin e parë të cilësisë së revizorëve të licensuar dhe firmave revizionuese të licensuara. Rishikimi duhet të kryhet në përputhje me përshkrimet në këtë ligj. | |
| **Neni 27**<br>**Hyrja në fuqi**<br><br>Ky ligj hynë në fuqi pesëmbëdhjet (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.<br><br>Jakup KRASNIQI<br>___________________<br><br>Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovë | **Neni 27**<br>**Hyrja në fuqi**<br><br>Ky ligj hynë në fuqi pesëmbëdhjet (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.<br><br>Jakup KRASNIQI<br>___________________<br><br>Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovë<br><br>V E R E J T J E:<br>Rekomanimet e paraqitura në këtë draftligj janë të bazuara në përvojën e drejtpërdrejt dhe në studimet e analiza të kryera posaçërisht për këtë angazhim të vet ekspertit dhe nuk janë në asnjë formë ose rrethanë qëndrime të GIZ-së (German International Cooperation) si kontraktor i punë së ekspertit.<br><br>Eksperti: Xhevat Meha ACCA | **Neni 27**<br>**Hyrja në fuqi**<br><br>Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.<br><br>**Ligji Nr. 04/ L-014**<br>**29 korrik 2011**<br><br>**Shpallur me dekretin Nr.DL-018-2011, datë 09.08.2011 nga Presidentja e Republikës së Kosovës Atifete Jahjaga.** |